

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN

25 PRILL 2021

**RAPORTI FINAL
PËR INCIDENCEN DHE HETUESHMERINË
E KRIMEVE ZGJEDHORE**



TIRANË
DHJETOR 2021

Për zgjedhje të lira e të ndershme, pa KRIME ZGJEDHORE

RAPORTI FINAL
PËR INCIDENCEN DHE HETUESHMERINË
E KRIMEVE ZGJEDHORE

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN

25 PRILL 2021

Grupi kryesor i monitorimit:

Gerti Shella (Dr.) – Autor
Kladiana Lala – eksperte
Nikoleta Kovaçi – Bashkëpunëtore
Albi Ramku, IT

Ky Raport është hartuar nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP.

Projektit është mbështetet nga Instituti Demokratik Amerikan, NDI, nën titullin:

"Për promovimin e integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri".

Pikëpamjet dhe gjetjet e shprehura në këtë raport nga INFOÇIP nuk reflektojnë domosdo ato të NDI.

I. Hyrje /Prezantim i shkurtër

Në 25 Prill 2021 u mbajtën Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, me mbështetjen e National Democratic Institute, NDI monitoroi në këto zgjedhje incidencën e krimeve zgjedhore të dyshuara¹ të cilat u kallëzuan në organin e akuzës. Në kuadër të monitorimit vlerësohet edhe eficientia e hetimit të krimeve zgjedhore nga organi i akuzës dhe ndëshkueshmëria e tyre nga gjykata.

Manipulimi i zgjedhjeve ka qenë dhe mbetet një shqetësim serioz për Shqipërinë. Dyshimi konstant mes aktorëve politikë se procesi i votimit mund të trukohet ka diktuar vazhdimisht ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon zgjedhjet dhe garanton integritetin e tyre. Legjislacioni penal është forcuar së tepërmi dhe krimet zgjedhore ndëshkohën vetëm me burgim në Republikën e Shqipërisë.

Që në vitin 2017, në prag të zgjedhjeve për Kuvendin, dy forcat kryesore politike PS dhe PD arritën konsensus që Kodi Penal të ashpërsojë masat ndëshkimore për personat që përfshihen në krime zgjedhore. Në Zgjedhjet për Kuvendin të mbajtura në 25 Prill 2021, parashikimet në Kodin Penal mbetën të pandryshuara në kuadër të reformës zgjedhore të ndërmarrë.

Në 17 Dhjetor 2020, Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion, SPAK mori juridiksion për të hetuar korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje. Kuvendi adoptoi ndryshime në Kodin e Procedurës Penale², duke përfshirë për herë të parë SPAK në hetimin e krimeve zgjedhore të parashikuara nga nenet 328 dhe 328/b i Kodit Penal, përkatësisht korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje.

Kreu X i Kodit Penal është i përbërë nga 15 nene³ dhe secili prej tyre parasheh ndëshkim me burg për veprave penale që cënojnë zgjedhjet demokratike. Ndëshkimi minimal është 6 muaj (nenet 236/a, 327/a, etj) kurse ndëshkimi maksimal është 7 vjet heqje lirie (nenet 326, 330, 330/a). Prokuroritë e zakonshme kanë juridiksion për hetimin e shumicës së veprave penale që parashikon Kreu X i KP (13 nga 15 gjithsej).

Pavarësisht parashikimeve ligjore në ashpërsim të vazhdueshëm, hetimet penale në fushën e zgjedhjeve nuk kanë rezultuar efektive në Shqipëri. Ato zgjasin shumë në kohë⁴. Shumica dërrmuese e kallzimeve penale pushohen nga vetë organi i prokurorisë. Zvarritja e hetimeve tej afateve procedurale është një tipar dallues për krimet e dyshuara zgjedhore. Edhe për ato pak dosje penale që dërgohen në gjykatë, ndëshkimi për autorët është i munguar në shumicën e rasteve. Krimet zgjedhore mbetën të pandëshkuara në zgjedhjet për Kuvendin në vitin 2017. Në Qershor të vitit 2020, Parlamenti Europian adoptoi 15 kushte për Shqipërinë, në këmbim të hapjes së

¹ Ky program mbështetet nga Instituti Demokratik Amerikan, NDI, nën titullin "Për promovimin e integritetit të zgjedhjeve në Shqipëri". **Pikëpamjet e shprehura në këtë raport paraprak nga INFOÇIP nuk reflektojnë medoemos ato të NDI.**

² Ligj Nr. 147/2020. Shkarko ligjin në linkun: <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/09/ligji-nr.-147-dt.-17.12.2020.pdf>

³ Ndryshimet e fundit që ka pasuar Kodi Penal datojnë në Maj 2017. Ato pasuan paktin Rama-Basha të 17 Majit dhe ashpërsuan ndjeshëm ndëshkimet për korrupsionin zgjedhor.

⁴ Shih për më shumë raportin e monitorimit të krimeve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin 2017, Link: <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2019/05/infocip-raporti-2019-krimi-zgjedhor-NO-LOGO.pdf>

bisedimeve zyrtare për anëtarësim. Mes këtyre kushteve ishte edhe ndëshkimi i atyre që kryejnë krime zgjedhor. Sipas amendamentit nr. 42⁵, nisja dhe përfundimi i gjyqeve penale ndaj atyre që janë përfshirë në shitblerje vote, përbën kusht për nisjen e bisedimeve me Shqipërinë.

Forcat politike që garuan në zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin në 25 Prill 2021, ranë dakort në 5 Qershor 2020⁶ që të adoptonin ndryshime në Kodin Zgjedhor. Mes këtyre ndryshimeve ishte edhe rritja e rolit të publikut në denoncimin e parregullsive zgjedhore. Pranë KQZ u krijua Portali i Denoncimeve të Publikut i cili krijoi akses të shtuar për denoncimin e krimeve të dyshuara zgjedhore.

Duke vlerësuar rëndësinë e posaçme të instrumentit penal në forcimin e integritetit të zgjedhjeve, INFOÇIP aktivizoi programin e monitorimit të krimeve zgjedhore në Zgjedhjet e 25 Prillit 2021 për Kuvendin e Shqipërisë. Synimi parësor i këtij programi është vlerësimi i incidencës së krimeve zgjedhore, klasifikimi i tyre sipas figurës së veprës penale si dhe shpërndarjes gjeografike të tyre. Monitorimi vlerëson gjithashtu eficiencën e hetimit të rasteve të kallzuara/referuara në Prokurori për këtë tipologji krimesh. Për herë të parë, objekt monitorimi janë edhe kallëzimet dhe/ose kërkesat për hetim në SPAK për krime zgjedhore.

Përmes mjeteve ICT ofrohet një pamje e detajuar e transferimit të çështjeve nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm në SPAK dhe anasjelltas. Po ashtu, për çdo kallzim penal të depozituar në SPAK, ofrohen të dhëna të detajuara mbi kallzimin dhe mbi kallëzuesin, datën e kallzimit, statusi i hetimit penal, baza ligjore e referuar etj. Monitorimi gjurmon ecurinë e hetimit penal deri në momentin ku procedimi pushohet apo shkon në gjykatë me akuzë penale për autorët e dyshuar. Për vendimet gjyqësore të dhëna për krime zgjedhore, rezultati dokumentohet dhe pasqyrohet në databazën e krijuar për këtë qëllim. Ky monitorim identifikon edhe shpërndarjen gjeografike të kallzimeve penale, me bazë qarku zgjedhor, me bazë bashkie dhe me bazë prokurorie e cila ka juridiksion tokësor dhe lëndor për këto lloj veprash penale.

Hetimi i thelluar dhe profesional i procedimeve penale si dhe ndëshkimi i fajtorëve i japin besueshmëri procesit zgjedhor dhe parandalojnë shfaqjen e sjelljeve të dënueshme në të ardhmen. Në këtë kuptim, SPAK dhe 22 prokuroritë e rretheve luajnë një rol të rëndësishëm për të mbrojtur integritetin e zgjedhjeve.

Ky raport vlerëson *vetëm në terma sasiorë* edhe sinjalizimet e shtetasve në Portalin e Denoncimeve nga Publiku, i cili u krijua dhe u administrua drejtpërdrejt nga KQZ⁷. Ndryshimet ligjore pajisën KQZ me funksionin e hetimit të sinjalizimeve për korrupsion zgjedhor. KQZ ka të drejtë që të vendosë sanksione administrative/gjobë për shkeljet zgjedhore si dhe referon në prokurori rastet që mbartin element të veprës penale në fushën e zgjedhjeve.

⁵ Depozituar në emër të PPE nga Kinga Gál

⁶ Kuvendi miratoi ndryshimet e dakortësuara në datë 5 Tetor 2020 (ligji nr 118/2020). Kodi Zgjedhor u ndryshua në 24 nënë të tij.

⁷ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/databaza-e-kallezimeve-totale/>

II. Përmbledhje ekzekutive

INFOÇIP vëzhgoi incidentet zgjedhore në Zgjedhjet për Kuvendin të mbajtura në 25 Prill 2021, dhe dokumentoi rastet e krimeve zgjedhore të dyshuara që u kallzuan në organin e akuzës. Monitorimi mbulon periudhën zgjedhore dhe shtrihet deri në Janar 2022. Rakordimi i fundit me organin e akuzës dhe KQZ është mbyllur në Janar 2022. Të dhënat janë të pasqyruar në portalin www.krimizgjedhor.com. Marzhi i gabimit në vlerësimin e të dhënave është 3%.

Burimet zyrtare të përdorura për mbledhjen e informacionit janë subjektet zgjedhore, Policia e Shtetit, prokuroritë e rretheve, SPAK, KQZ. Burime të tjera referimi janë organet mediatike që raportuan mbi situatën zgjedhore, por edhe institucionet shtetërore që sinjalizuan prokurorinë për prezencë të mundshme të krimeve zgjedhore. INFOÇIP ka mbledhur informacione në rrugë operative mbi numrin e kallzimeve penale dhe ecurinë e hetimeve përmes një ekipi monitoruesish.

Gjetjet e raportit mblidhen dhe organizohen në dy drejtime:

1. *Raste të raportuara nga subjekti inicues (sender) i nje denoncimi apo kallzimi. Këto mund të jenë subjekte zgjedhore (pati politike), policia, institucione të tjera apo qytetarë*
2. *Raste/kallzime të raportuara zyrtarisht nga institucioni pritës (receiver) që në rastin konkret janë prokuroritë e rretheve dhe/ose SPAK;*

Gjatë vitit 2021, Prokuroria e Përgjithshme informoi publikun dhe median 6 herë zyrtarisht mbi situatën e krimeve zgjedhore⁸. Sipas njoftimit të fundit të shpërndarë në datë 2 Nëntor 2021⁹, në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm u regjistruan **158 njoftime/kallzime** për vepra penale që prekën zgjedhjet e 25 Prillit 2021¹⁰. Prej tyre, 91 ishin drejtpërdrejt në formën e kallzimeve¹¹. Pjesa tjetër ishin referime nga policia e shtetit dhe kërkesa për hetim nga institucione të tjera. Prokuroritë e rretheve gjyqësore regjistruan **82 procedime** për vepra penale që çenojnë zgjedhjet, prej të cilave 2 u regjistruan kryesisht.

Sipas të dhënave që u mblodhën direkt nga 22 prokuroritë e rretheve¹² prej monitoruesve të INFOÇIP u raportua për **148 kallzime** apo referime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Kjo shifër (148) përkon edhe me të dhënat që dokumentoi INFOÇIP gjatë periudhës zgjedhore, me burim subjektet që depozituan kallzime. Rreth 74 prej tyre janë të dokumentuara me faksimile¹³.

⁸ https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Perditesim_mbi_veprat_penale_ne_fushen_e_zgjedhjeve.html

⁹ Përditësimi i fundit i të dhënave zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme mban datën 2 Nëntor 2021.

¹⁰ Vepra penale që bien në parashikimet e kreut X të Kodit Penal, të ndryshuar.

¹¹ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/11/02/prokuroria-e-pergjithshme-ben-perditesimin-e-situates-per-krimet-zgjedhore/>. Hap këtu linkun e njoftimit: https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Perditesim_mbi_veprat_penale_ne_fushen_e_zgjedhjeve.html

¹² deri në fund të Dhjetorit 2021

¹³ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/databaza-e-kallzimeve-totale/>

Diferenca prej 10 kallzimesh midis shifrës që raporton Prokuroria e Përgjithshme dhe të dhënave që ofrojnë prokuroritë e rretheve mund të vijë si pasojë e momentit të transferimit të çështjeve nga SPAK dhe anasjelltas. Prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm raportuan në Nëntor 2021 se transferuan 24 njoftime në SPAK, ndërkohë SPAK konformoi në Dhjetor 2021 se transferoi 22 procedime penale në prokuroritë e rretheve. Nuk përjashtohet mundësia që sistemi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave që përdor organi i prokurorisë të ketë inkonsistenca.

Në datë 3 Dhjetor 2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, njoftoi zyrtarisht vendimin¹⁴ për të kallëzuar penalisht pranë organit të prokurorisë shkeljet e konstatuara nga komisionerët dhe stafet ndihmëse në 10% të qendrave të numërimit. KQZ depozitoi kallëzime penale për shkeljet e konstatuara në 67 anëtarë të 18 grupeve të numërimit¹⁵. Këto kallëzime, janë dërguar në 7 prokurori, përkatësisht Korçë, Berat, Gjirokastrë, Tiranë, Lezhë, Elbasan dhe Shkodër.

KQZ konfirmoi gjithashtu për INFOÇIP se nga procesi i kryqëzimit të të dhënave të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI) është konstatuar identifikim i dyfishtë në 32 raste. Për këto parregullsi KQZ depozitoi gjithashtu kallëzim penal në 11 prokurori, konkretisht Prokuroria Vlorë, Tirane, Shkodër, Lezhë, Korçë, Gjirokastrë, Fier, Elbasan, Durrës, Dibër, Berat.

Bazuar në sa më sipër, KQZ ka depozituar të paktën 18 kallzime penale në prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm gjatë muajit Dhjetor 2021. Vetëm Prokuroria e Beratit ka konfirmuar për kallëzuesit (KQZ) regjistrimin e procedimit penal brenda kohës në të cilën hartohet ky raport. Praktika sugjeron se kallzimet e KQZ përgjithësisht regjistrohen si procedime penale nga ana e prokurorisë.

Në 17 Dhjetor 2020, Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion, SPAK mori juridiksion për të hetuar korrupsionin aktiv dhe pasiv në zgjedhje (neni 328, 328/b i K.P.) Zgjedhjet e 25 Prillit 2021 caktuan edhe debutimin e parë për hetimin e krimeve zgjedhore nga SPAK. Në 24 Dhjetor 2021, SPAK konfirmoi për monitoruesit e INFOÇIP se kishte të regjistruara 76 kallzime penale në fushën e zgjedhjeve. Prej tyre, u regjistruan si procedime penale **57 kallëzime**. Ndërkohë, 6 procedime erdhën në SPAK me transferim nga prokuroritë e rretheve¹⁶. Më herët, SPAK raportoi për një numër më të madh kallzimesh; deri ditën e votimit në 25 Prill 2021 u regjistruan 91 kërkesa për hetim, prej të cilave 33 u regjistruan si procedime penale.

INFOÇIP vëzhgoi në mënyrë periodike ecurinë e kallëzimeve penale në SPAK. Në muajin Prill 2021, monitorimi dokumentoi me faksimile 72 kallzime/njoftime për krime të dyshuara zgjedhore të cilat adresojnë specifikisht SPAK nga subjektet zgjedhore (PD, LSI) dhe Presidenti i Republikës.

¹⁴ <http://kqz.gov.al/2021/12/03/miratothen-raportet-e-verifikimit-paszgjedhor-te-10-te-qendrave-te-votimit-te-zgjedhjeve-te-dates-25-prilli-2021/>

¹⁵ Lista e plotë: http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/12/lidhja_grupet_e_numerimit.pdf

¹⁶ shih një shëmbull këtu: https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/05/k187_fq1_anonimizuar.pdf

Faksimilet janë ngarkuar në një databazë të posaçme për SPAK¹⁷. Monitoruesit e INFOÇIP raportuan për një total prej 82 rastesh të kallzuara në SPAK. Të dhënat u morën në rrugë operative.

Duke kryqëzuar informacionet e mbledhura, mund të pohohet se gjatë kohës zgjedhore dhe pas përfundimit të saj, deri në 24 Dhjetor 2021, **SPAK mund të ketë administruar rreth 115 kërkesa për hetim** (91 para zgjedhjeve dhe rreth 24 tranferime nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm, kryesisht pas zgjedhjeve).

Të dhënat e referuara nga SPAK mbi procedimet penale të regjistruara rezultojnë dinamike. Në Korrik 2021 kreu i SPAK informoi TVSH se ishin regjistruar 59 procedime penale¹⁸ për vepra në fushën e zgjedhjeve. Në Dhjetor 2021, për monitoruesit e INFOCIP u raportua për vetëm 57 procedime penale të regjistruara në fushën e zgjedhjeve. Në fillim të vitit 2022, SPAK raportoi gjithsej 45 procedime penale të regjistruara për krime zgjedhore (35 nën fushën e nenit 328 të K.P, 2 në nenin 328/b, 7 në fushën e nenit 328/a dhe 1 në fushën e nenit 325). Shifrat mund të jenë e lëvishme për shkak të procesit të transferimit të dosjeve si pasojë e kompetencës lëndore midis SPAK dhe prokurorive të zakonshme dhe anasjelltas.

Bazuar në sa më sipër, në Zgjedhjet e 25 Qershorit 2021 u depozituan në total (22 prokurori rrethesh+SPAK) të **paktën 291 njoftime dhe/ose kallzime për vepra penale të dyshuara që çënojnë zgjedhjet**. Prej tyre 115 u adresuan në SPAK, kurse 176 në prokuroritë e rretheve (këtu përfshihen edhe 18 kallëzimet e nisuar nga KQZ në Dhjetor 2021). Në 6 raste të tjera është depozituar kallëzim për vepra penale kundër jetës apo kundër personit (pra nuk janë krime kundër zgjedhjeve), por që gjithsesi kanë sfond të pastër zgjedhor²⁰.

Nga ky total, mund të jenë regjistruar të paktën 140 procedime penale nga organi akuzës (SPAK dhe prokuroritë e zakonshme të marra së bashku). Deri në Janar 2022, kjo shifër ka qenë me tendencë rritje (të paktën me 17 raste plus), pasi prokuroritë e rretheve kishin nën shqyrtim kallzimet e depozituara nga KQZ gjatë muajit Dhjetor 2021²¹. Mund të thuhet se **nga totali i kallzimeve të paraqitura për krime zgjedhore në Zgjedhjet e 25 Prillit, pothuajse gjysma e tyre u regjistruan si procedime penale.**

Për krahasim, në zgjedhjet për Kuvendin të mbajtura në 25 Qershor 2017, në prokurori pati 190 kallzime dhe/ose referime për krime të dyshuara zgjedhore prej të cilave u regjistruan vetëm 64 procedime penale²². Ndërkohë në Zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2022, shifra e

¹⁷ Zvogëlimi e shifrës mund të ketë ardhur jo vetëm si pasojë e procesit të transferimit të dosjeve, por edhe e kërkesave të dyfishta. Kërkesat për hetim të bëra nga Presidenti i Republikës (18 të tilla) adresojnë njëkohësisht SPAK por edhe prokuroritë e zakonshme. Shih një shembull këtu: <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/databaza-e-kallzimeve-spak-2/>

¹⁸ <https://youtu.be/dwuNqUJzOo>

²¹ lista me inicialet e emrave të komisionerëve të kallzuar nga KQZ në dhjetor 2021: http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/12/lidhja_grupet_e_numerimit.pdf

²² Shih për më shumë Raportin Monitorues të INFOCIP, fq.5, link: <https://www.krimizgjedhor.com/wp-content/uploads/2019/05/infocip-raporti-2019-krimi-zgjedhor-NO-LOGO.pdf>

kallzimeve ka pësuar rritje me rreth 101 raste më shumë. Shifra e regjistrimit të procedimeve penale është rritur mbi dyfish më shumë (64 në 2017-ën vs. 140+ në 2021-in). Kjo e dhënë krahasuese flet në favor të përdorimit të shtuar të instrumentit penal për garantimin e integritet të zgjedhjeve nga aktorët e përfshirë në këtë proces.

Deri në 24 Dhjetor 2021, vetëm një (1) procedim penal i hetuar nga SPAK arriti të gjykohej plotësisht nga gjykata. Personat e akuzuar nga SPAK (2 gjithsej) kanë marrë dënim penal për krime zgjedhore. SPAK konfirmoi gjithashtu në Dhjetor 2021 se edhe një tjetër procedim penal ishte hetuar plotësisht dhe i ishte nisur gjykatës për vendim²³. Koha e hetimit të dy çështjeve në fjalë konsiderohet e shpejtë.

Prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm nuk raportuan gjatë vitit 2021 për persona të hetuar prej tyre për krime zgjedhore të cilët u dënuan nga gjykata penale. Në njoftimet zyrtare për shtyp mbi tematikën e krimeve zgjedhore (6 gjithsej²⁴) të cilat janë afishuar në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, nuk ka të dhëna për persona të dënuar për krime zgjedhore.

Në Raportin Zyrtar për kriminalitetin në vitin 2021, Prokuroria e Përgjithshme i ka kushtuar një hapësirë të vogël statistikës për krimet zgjedhore, pavarësisht se viti në fjalë ishte vit zgjedhor. Në këtë Raport flitet për 46 persona të dënuar për krime zgjedhore. Kjo shifër gjithsesi merret me rezervë në këtë vlerësim pasi konstatohet inkoherencë në analizë nga shkruarit e raportit²⁵. Raporti i INFOCIP analizon gjithsesi situatën e ndëshkueshmërisë së krimeve zgjedhore referuar të dhënave të mbledhura brenda vitit 2021.

Deri në Nëntor 2021, përfunduan me vendim pushimi (nga gjykata) 20 procedime të nisura nga prokuroritë e zakonshme. Nuk ka të dhëna lidhur me subjektet zgjedhore apo subjekte të tjera që të kenë apeluar vendimet e pushimit të pranuar nga gjykata. Trendi i pushimit të procedimeve penale për krime zgjedhore të dyshuara konsiderohet i lartë.

Sa i takon SPAK, janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim 6 procedime penale, sipas rakordimit të datës 24 Dhjetor 2021. Vendimet gjyqësore për pushim arrijnë në 19% të totalit të

²³ Shih për më shumë: <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/11/26/spak-dergon-ne-gjyq-kandidatin-per-deputet-qe-u-kap-duke-blere-vota-ne-23-prill/>

²⁴ https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Perditesim_mbi_veprat_penale_ne_fushen_e_zqjedhjeve.html

²⁵ Shih për më shumë fq. 165-166 ne kete link:

https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_Kuvendit_per_Kriminalitetin_2021_31_03_22_PP_6411.pdf. Në tekstin e raportit zyrtar të Prokurorit të Përgjithshëm flitet ndër të tjera "për 2 çështje penale me 6 të pandehur, prej të cilëve janë dënuar 19" (paragrafi I dytë faja 166). Po ashtu në Raport flitet për 47 procedime penale gjithsej në fushën e veprave që çënojnë zgjedhjet ndërkohë që në datë 2 nëntor 2021, Prokuroria e Përgjithshme informoi zyrtarisht për 82 procedime penale të regjistruara në prokuroritë e rrethepër vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Ndërkohë, në Raportin Zyrtar mbi kriminalitetin gjatë vitit 2021, Prokurori i Përgjithshëm raporton për vetëm 47 procedime gjithsej në fushën e veprave penale që çënojnë zgjedhjet.

procedimeve penale të regjistruara në SPAK dhe prokuroritë e rretheve të marra së bashku (deri 9 muaj pas zgjedhjeve të 25 Prillit 2021). Pushimi i procedimeve penale manifeston tendencë rritëse.

Nga të dhënat e analizuara, rezultojnë më tepër kërkesa në gjykatë nga ana prokurorisë për të pushuar hetimet (çështjet penale) se sa për të dënuar autorët e hetuar për krime zgjedhore. Ky monitorim nuk ka konstatuar që organi i akuzës të këtë administruar ankime për kallzim të rremë lidhur me rastet për të cilat është kërkuar pushimi i procedimit penal. Po ashtu nuk ka të dhëna për ankimim të subjekteve zgjedhore në gjykatë kundër vendimeve të pushimit nga ana prokurorisë.

Nga të dhënat që ka dokumentuar INFOÇIP, 165 kallzime janë depozituar nga subjektet zgjedhore dhe 9 nga qytetarët, 40 janë referime nga Policia e Shtetit dhe 18 janë kërkesa për hetim nga Presidenti i Republikës. Po ashtu, KQZ ka depozituar të paktën 18 kallzime në prokuroritë e rretheve pas verifikimit prej të saj të verifikimit paszgjedhor të 10% të qendrave të votimit të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021. Për 41 kallzime të tjera nuk është arritur të sigurohen të dhëna cilësuese gjatë kohës së këtij monitorimi.

Subjekti zgjedhor PD ka pohuar se ka bërë 185 kallzime në kohë fushatë (130 në prokuroritë e zakonshme dhe 55 në SPAK). Kjo shifër është më e lartë se sa ajo që raportohet nga organi i prokurorisë. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka aktivizuar mekanizmin e kallzimeve penale më shumë se çdo subjekt tjetër zgjedhor në Zgjedhjet e 25 Prillit.

INFOÇIP dokumentoi me faksimile se gjatë fushatës zgjedhore dhe deri në ditën e votimit prej saj u depozituan 50 kallzime në SPAK dhe 73 kallzime në prokuroritë e rretheve. Pas mbylljes së procesit zgjedhor, shifra e kallzimeve të depozituara nga PD rezulton të jetë më e rritur. Sipas të dhënave të referuara nga sekretari i përgjithshëm i PD, Gazment Bardhi në datë 17 Nëntor 2021²⁶, nga PD janë depozituar në total 130 kallzime në prokuroritë e rretheve dhe 55 kallzime në SPAK për krime të dyshuara zgjedhore. Kjo shifër nuk përkon me shifrën zyrtare që është referuar nga organi i prokurorisë. Megjithatë diferenca prej 20 kallzimesh²⁷ pritet të adresohet në muajt në vijim, edhe në kuadër të veprimtarisë hetimore që po zhvillon Kuvendi i Shqipërisë. Shumica dërrmuese e kallzimeve të depozituara në SPAK, mbajnë firmën e Sekretarit të Përgjithshëm të PD, Gazment Bardhi.

Për shkak të ndarjes së kompetencave për hetimin e krimeve zgjedhore midis prokurorive të zakonshme dhe SPAK, në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 u vu re një lëvizje qarkulluese e kallzimeve

²⁶ Shih deklaratimet mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Hetimin e Zgjedhjeve të 25 Prillit, link: <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/11/18/4409/> ose hape direkt në audio-video në YouTube: <https://www.youtube.com/watch?v=5by04XeBPx0&t=12s>

²⁷ Gjatë monitorimit, INFOÇIP ka konstatuar se në qarkun zgjedhor Fier, subjekti zgjedhor PD ka hartuar ta paktën 73 kallzime ndërkohë që Prokuroria e Fierit dhe Lushnje raportojnë se kanë administruar vetëm raportin se ka marrë gjithsej 36 kallzime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve.

por edhe procedimeve penale. Nga evidencat statistikore që janë ballafaquar për efekt të këtij monitorimi, SPAK transferoi pranë prokurorive të juridiksionit të zakonshëm rreth 22 kallëzime penale gjatë vitit 2021. Numri më i lartë u regjistruar në prokurorinë e Tiranës, me 14 transferime nga SPAK deri në fund të Nëntorit 2021.

Nga ana tjetër, prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm raportuan se kanë transferuar rreth 24 njoftime në SPAK gjatë vitit 2021. Me numrin më të lartë paraqitet Prokuroria Gjyrokastër me 7 kallëzime të transferuara në SPAK për mungesë kompetence lëndore. Për shkak të procesit të transferimit të çështjeve penale nga SPAK në prokuroritë e rretheve dhe anasjelltas, shifra tenton të jetë dinamike dhe lëviz brenda një marxhine gabimi metodologjik 3% .

Vihen re mospërputhje midis shifrave që ka raportuar Prokuroria e Përgjithshme dhe shifrave që ofrojnë vetë subjektet zgjedhore që kanë depozituar kallëzime në organin e akuzës. Konkretisht, subjektit zgjedhor PD ka deklaruar se depozitoi në total 130 kallëzime në prokuroritë e rretheve dhe 55 kallëzime në SPAK për krime të dyshuara zgjedhore²⁸.

Prokuroria e Përgjithshme njoftoi zyrtarisht në datë 2 Nëntor 2021²⁹ se kishte marrë drejtpërdrejt 91 kallëzime (në prokuroritë e rretheve), prej të cilave vetëm 70 ishin kallëzime të subjekteve politike/kandidatëve, 3 ishin njoftime të shtetasve dhe 18 njoftime të institucioneve shtetërore. Mbetet të kuptohet se çfarë konsiderohen njoftime apo kallëzime jo-direkte nga Prokuroria e Përgjithshme, kategori në të cilën bien rreth 67 njoftime (mbi 42%) për vepra penale në fushën e zgjedhjeve (nga 158 gjithsej që ajo raporton se ka marrë).

Prokuroria e Fierit raportoi se mori gjithsej 17 njoftime/kallëzime për krime zgjedhore, ndërkohë që monitoruesit e INFOÇIP kanë dokumentuar me faksimile 35 kallëzime vetëm nga subjekti zgjedhor PD në territorin juridiksional të Prokurorisë Fier.

Prokuroria Lushnjë konfirmoi për monitoruesit e INFOÇIP se mari gjithsej 19 kallëzime/njoftime për krime të dyshuara zgjedhore. Ndërkohë, subjekti zgjedhor PD dëshmon se vetëm ai ka dorëzuar 38 kallëzime për vepra penale të dyshuara që kanë ndodhur në territorin e bashkive mbi të cilat ka juridiksion Prokuroria Lushnjë.

Ndëshkueshmëria e krimeve zgjedhore vlerësohet shumë e ulët në raport me kallëzimet që u paraqiten në Zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Deri në Dhjetor 2021, vetëm një çështje penale e hetuar nga SPAK mori vendim fajësie në Gjykatën e Posaçme Posaçme të Shkallës së Parë për

²⁸ Shih deklaratimet mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Hetimin e Zgjedhjeve të 25 Prillit, dokumentuar nga INFOÇIP, link: <https://www.youtube.com/watch?v=5by04XeBPx0&t=12s>

²⁹ Njoftimi zyrtar datë 2 Nëntor 2021, link:

https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Perditesim_mbi_veprat_penale_ne_fushen_e_zgjedhjeve.html

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Çështja penale³⁰ ka qenë në ngarkim të dy punonjësve të Bashkisë Dibër, të cilët u kapën në flagrancë me shuma monetare dhe karta identiteti në mjetin e tyre në Njësinë Administrative Maqellarë. Akuzat ndaj tyre për krime zgjedhore u provuan dhe Gjykata e Posaçme dënoi me 18 muaj shtetasit D.Xh dhe A.C., por për shkak të gjykimit të shkurtuar masa e dënimit u reduktua në 12 muaj heqje lirie³¹.

Deri në fund të vitit 2021, SPAK përfundoi gjithashtu hetimet dhe dërgoi në gjyq dosjen e shitblerjes së votës në të cilën nën akuzë u vu E.J, i cili garoi si kandidat për deputet në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 në Qarkun Tiranë. Procedimin penal Nr.131/2021, për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje” u bazua në pamjet filmike të transmetuara në datën 23 Prill 2021 në kanal televiziv “Top News”.

SPAK konfirmoi për monitoruesit e INFOÇIP se, deri në Dhjetor 2021 ishin dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim 6 procedime penale. Deri në Janar 2022, kjo shifer shkoi në 8 (7 pushime për vepra të dyshuara që bien nën parashikimet e nenit dhe ka tendencë rritjeje. Për 22 procedime penale ishin marrë më parë gjat vitit 2021 vendime për shpalljen e moskompetencës. Në vitin 2022 u mbartën 27 procedime penale. Nuk rezulton që subjektet zgjedhore dhe/ose fizike të kenë depozituar ankim në gjykatë për mbyllje të procedimeve penale nga SPAK.

Nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm, deri në Nëntor 2021, nuk konfirmohet fakti që persona të akuzuar për krime zgjedhore të ishin dënuar me vendim fajësie nga ndonjë gjykatë. Referuar njoftimeve zyrtare, në gjykim kanë qenë 4 çështje me 4 persona të akuzuar. Shifra mund të ketë ndryshuar në muaj në vijim, por Prokuroria e Përgjithshme nuk ka dhënë informacion për përditësimin e situatës pas datës 2 Nëntor 2021.

Deri në përditësimin e fundit që ka bërë organi i akuzës për vitin 2021, nga çështjet e regjistruara kanë përfunduar me vendim pushimi 20 prej tyre. Janë pezulluar 3 çështje penale, ndërkohë që 13 njoftime kanë qenë ende në fazën e verifikimit paraprak. Për 34 kallëzime, është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga organi i prokurorisë. Gjithashtu, 24 njoftime/kallëzime i kanë kaluar me transferim SPAK për kompetencë lëndore. Sa më sipër përbëjnë rreth 94 raste që do të thotë se 60% e totalit të kallëzimeve janë pushuar ose janë përcjellë pa dënimit të autorëve të krimeve zgjedhore nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm. Subjektet zgjedhore nuk kanë konfirmuar të kenë bërë ankim në gjykatë ndaj pushimit të çështjeve të tyre prej organit të akuzës.

Po sipas të dhënave zyrtare nga Prokuroria e Përgjithshme, deri në fund të vitit 2021 vetëm 10 persona kanë qenë në ndjekje penale për krime të dyshuara që çenojnë zgjedhjet. Të arrestuar në flagrancë numëroheshin 4 persona, ndërkohë që është kërkuar masë sigurie “arrest në burg” për 3 persona; kërkesa është pranuar për vetëm 2 prej tyre.

³⁰ Procedimin penal nr.136 viti 2021

³¹ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/12/01/tantuan-te-blinin-vota-denohen-me-nga-1-vit-burg-dy-djente-e-dibres/>

Bazuar në këto të dhëna, mund të pohohet se në zgjedhjet e fundit ose nuk ka patur aq krime zgjedhore sa pretendohet nga subjektet zgjedhore, ose ka patur kallëzime të rreme për krime zgjedhore, ose krimet zgjedhore të denoncuar nuk janë hetuar siç duhet sa kohë që nuk ka vendime fajësie për to në shkallë domethënëse.

Nuk ka të dhëna që të konfirmojnë nisjen e hetimeve nga Prokuroria për kallëzim të rremë në fushën e veprave penale që çënojnë zgjedhjet. Po ashtu, ky raport nuk ka siguruar dot të dhëna që subjektet që kanë depozituar kallëzim të kenë ankimuar vendimet e pushimit të çështjeve të tyre nga ana e organit të akuzës.

Ky monitorim konstaton se intensiteti më i lartë i kallëzimeve penale ka ndodhur gjatë kohës së fushatës zgjedhore deri ditën e votimit. Pas shpalljes së rezultatit zgjedhor, vetëm KQZ ka raportuar për depozitim kallëzimesh penale. Në datë 3 dhjetor 2021, pasi shqyrtoi raportin me gjetjet dhe problematikat e konstatuara, KSHZ vendosi t'i kërkojë KAS vendosjen e sanksioneve administrative ndaj 32 sekretarëve të komisioneve të qendrave të votimit si dhe të bëjë kallëzim penal pranë organit të prokurorisë³² për shkeljet e konstatuara nga 67 anëtarët e 18 grupeve të numërimit (lista e plotë³³). Po ashtu, KQZ ka konfirmuar zyrtarisht se ka dërguar në 11 prokurori kallëzime për votim të shumëfishtë për 32 raste të konstatuara nga verifikimi i materialeve zgjedhore.

Përveç kallëzimeve për vepra penale të dyshuara që bien në parashikimet e Kreut X të K.P., janë dokumentuar edhe të paktën 6 raste me krime serioze (kundër jetës, kundër personit) të cilat kanë sfond të pastër zgjedhor. Ngjarja më e rëndë u shënuar në qytetin e Elbasanit ku mbështetës të subjektit³⁴ zgjedhor PD vranë me armë zjarri një mbështetës të subjektit zgjedhor PS³⁵. Edhe pse fillimisht u raportua për materiale kompromentuese me natyrë zgjedhore me vendin e krimit, prokuroria në një vendim të mëvonshëm nuk e konfirmoi këtë pretendim.

Një tjetër ngjarje u dokumentua në Qarkun Dibër, ku militantë dhe njerëz të afërt me kandidatin për deputet të PD morën peng për disa orë dy shtetas që po blinin vota për llogari të subjektit zgjedhor PS. Shtetasit në fjalë u dënuan më vonë me vendim gjykatë të formës së prerë pasi u gjetën fajtorë për veprën penale të korrupsionit aktiv në zgjedhje (*neni 328 i K.P.*).

Prokuroritë e rretheve me numrin më të lartë të procedimeve të regjistruara janë Tirana (33), Lushnja (19) dhe Gjirokastra (15). Prokuroria Tiranë ka numrin më të madhe të çështjeve penale të

³² <http://kqz.gov.al/2021/12/03/miratohen-raportet-e-verifikimit-pas-zgjedhor-te-10-te-qendrave-te-votimit-te-zgjedhjeve-te-dates-25-prilli-2021/>

³³ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/lidhja_grupet_e_numerimit.pdf

³⁴ Refruar nga zyrtarë të lartë të PD si "Struktura e Mbrojtjes së Votës"

³⁵ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/05/03/vrasja-e-elbasanit-dhe-dilemat-per-pasje-ose-jo-te-elementeve-te-krimet-zgjedhor/>

ardhura me transferim nga SPAK për mungesë kompetence nga ky i fundit (14 të tilla në rakordimin e muajit Dhjetor 2021). Ndërkohë, Prokuroria Gjyrokastër rezulton me numrin më të lartë të procedimeve penale të transferuara prej saj në drejtim të SPAK për mungesë kompetence.

Nëse të dhënat organizohen mbi bazë qarku zgjedhor, rezulton se Qarku Fier ka numrin më të lartë të kallëzimeve penale në fushën e zgjedhjeve të depozituara pranë organit të akuzës. Në total përllogaritet një numër prej 28 procedimesh penale të regjistruara në prokuroritë e rrethit Lushnjë dhe Fier, të cilat kanë juridiksion tokësor për Qarkun Zgjedhor Fier.

Nga të dhënat e disponuara prej subjektit zgjedhor Partia Demokratike, rezulton se në Qarkun Fier ka patur të paktën 39 kallëzime penale më shumë se sa shifra që referon organi i prokurorisë së rrethit si procedime të regjistruara. Këto 39 raste të denoncuara/kallzuara ndahen respektivisht 24 në prokurorinë Fier dhe 15 në Prokurorinë Lushnje. Nuk përjashtohet mundësia që faktet penale të jenë bashkuar në një fashikull (çështje) penale.

Gjatë fushatës, një bazë të dhënash me të dhëna personale, detajet e kontaktit dhe preferencat politike të rreth 900,000 qytetarëve shqiptarë, doli në media. Baza e të dhënave u bë shumë shpejt e aksesueshme online nga çdo përdorues interneti. Media, Presidenti i Republikës, partitë opozitare bënë thirrje për hetim nga SPAK për keq-përdorimin e të dhënave personale të qytetarëve për përfitime elektorale të një partie politike. Një kallëzim penal u regjistrua nga SPAK pasi Presidenti i Republikës kërkoi zyrtarisht hetim të shpejtë. A ashtëquajtura “çështja e patronazhistëve” u pushua nga SPAK për mungesë juridiksioni. Ajo i kaloi Prokurorisë së Tiranës për hetime të mëtejshme. Përdorimi i të dhënave personale për qëllime elektorale nga partitë politike nuk konsiderohet krim elektorale sipas përcaktimeve të kreut X të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Raportohet se 161 qytetarë bënë kallëzim në prokurori për përdorim të pa-autorizuar të të dhënave të tyre personale³⁶.

Pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor³⁷ dhe në Ligjin për Sinjalizuesit³⁸, KQZ krijoi dhe administroi gjatë zgjedhjeve të 25 Prillit Portalin e Denoncimeve nga Publiku. Në total u dokumentuan 135 sinjalizimi për parregullsi në këtë Portal. Në përfundim të shqyrtimit administrativ të këtyre rasteve, KQZ nuk gjeti element të veprës penale në asnjë nga denoncimet e publikut për parregullsi zgjedhore. Rrjedhimisht, nuk pati asnjë referim nga KAS/KQZ në organin e prokurorisë për ndjekje të mëtejshme penale për këto denoncime.

³⁶ Burimi: Top Story, minuta 10, link: <https://www.youtube.com/watch?v=g5iEw0Z4vrg>

³⁷ <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/09/kodi-zgjedhor.pdf>

³⁸ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/legjislacioni-per-sinjalizuesit/>

Rekomandime

INFOCIP ka hartuar një set rekomandimesh, të cilat adresojnë njëkohësisht Kuvendin e RSH, Komisionin e Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore, Prokurorinë e Përgjithshme, Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve. Këto rekomandime janë si më poshtë vijon:

1. ***Ligjvënësi të diferencojë masën e ndëshkimit të parashikuar për personin që e blen votën nga personi që e shet votën.*** Aktualisht Kodi Penal i Ndryshuar kriminalizon njësoj palët ndërvepruese në një veprë penale, sikurse në rastin konkret është parashikuar në nenet 328 dhe 328/b. Në të dyja figurat e veprës penale, ligjvënësi ka parashikuar dënim nga 1- 5 vjet burg për autorët e veprës penale që përfshihen në transksionin korruptiv.

Penalizimi i zgjedhësit që pranon shpërblimin apo premtimin për një të mire materiale apo favore të padrejta, zvogëlon mundësinë e vënies përpara drejtësisë të personave që përdorin pushtetin apo postin publik/politik për të blerë vota. Nga ana tjetër, duke patur parasysh diferencat e pranura që ekzistojnë në statusin shoqëror dhe ekonomik mes dy kategorive respektive, aplikimi i të njëjtës masë dënimi si për atë që ble vota ashtu dhe për atë që shet votën e barazon korruptionin sistemik (domethënës) me korruptionin e vogël (patty cash corruption). Blerja e votës nga subjektet zgjedhore është një operacion i strukturuar (ka një qëllim dhe plan konkret për arritjen e tij), ndërkohë që nuk tek subjekti që shet votën nuk verifikohen këto premise.

Subjekti zgjedhor ble vota në shkallë të gjerë dhe përmes një rrjeti të strukturuar, i cili targeton viktimat e tij përmes infrastrukturës dhe kapaciteve që disponojnë partitë politike (subjektet zgjedhore). Për këtë arsye, blerja e votës ka tiparet e krimit të organizuar. Ky aktivitet kriminal synon qartësisht kapjen e pushtetit (korruption i nivelit më të lartë) si dhe ndërlikohet ngushtë me financimin e paligjshëm të partive, i cili është i parashikuar si një aktivitete kriminal më vetë.

- ***INFOCIP rekomandon forcimin e masës së dënimit për personat që janë të përfshirë në operacionet apo grupet e strukturuar të blerjes së votave për qëllim të kapjes së pushtetit.***
- ***Po ashtu, INFOCIP rekomandon zbutjen e dëimit penal të parashikuar për personat që janë pjesa fundore e transaksionit kriminal të shit-blerjes së votës.***

Në pjesën e dytë të rekomandimit, dominon edhe arsyeja praktike që sugjeron se personat që blejnë vota për llogari të një subjekti zgjedhor janë më të paktë në numër se personat që shesin votën. Ai që shet votën është i përfshirë në vetëm një transaksion (atë të votës së tij), ndërkohë personi apo grupi që ble vota është i përfshirë në transaksione të shumëfishta duke konsumuar të njëjtën figurë të vepres penale disa herë (disa dhjetëra apo disa qindra herë).

Zbutja e dënimit penal për kategorinë e votuesve që shesin votën në këmbim të parave/favoreve/premtive të paligjshme arsyetohet në këtë rekomandim edhe përmes rrethanës praktike e cila sugjeron se ky fenomen është I përhapur në Shqipëri dhe në përfshihen gjithmonë e më shumë qytetarë. Nëse parafytyrojmë në një rrethanë hipotetike kapjen, gjykimin dhe ndëshkimin e të gjithë personave që kanë konsumuar korrupsion pasiv zgjedhor (shitje të votës sipas parashikimeve të nenit 329/b¹) atëherë mund të përballeshim me situatën e mungesës së kapaciteteve në burgje për këtë kategori kriminelës. Neni 328/b parashikon 1-5 vjet burg për personat që do të gjenden fajtorë.

Po ashtu, numri i lartë i personave që prezumohen se përfshihen në shitjen e votës kundrejt parave/favoreve të ofruara do të mbingarkonte në ekstrem kapacitete e pushtetit gjyqësor, duke provokuar deri një kolaps të gjykatave për shkak të kushteve specifike të Shqipërisë.

INFOCIP rekomandon de-kriminalizimin e korrupsionit pasiv dhe konsiderimin e toj kundravajtje penale, që ndëshkohet vetëm me gjobë. Ndëshimi me penalitet financiar i korrupsionit pasiv në zgjedhje është proporcional dhe në një masë të mirë edhe restituviv, sa kohë që për personat e përfshirë në këtë proces, në finale transaksioni financiar i shitjes së votës mund të rezultojë me humbje. Psh. Nëse një votë shitet për 100 apo 200 euro, atëherë mund të rekomandohet që sanksioni financiar të jetë 10 fish më shumë se sa shifrat e transaksionit korruptiv.

Një tjetër rekomandim plotësuar lidhur me de-kriminalizimin e shitjes së votës mund të ishte edhe shoqërimi i sanksionit financiar për shkeljen administrative me heqjen e të drejtës për të votuar në zgjedhjet e ardhshme. Për këtë të fundit, ligjvënësi do të duhet të konsiderojë gjithsesi aplikimin e ndryshimeve në tekstin e Kushtetutës së Shqipërisë, dhe jo vetëm në Kodin Penal, Kreu X.

2. Denoncimet e publikut për parregullsi në zgjedhje, të adresuar përmes Portalit të Denoncimeve që u krijua dhe administrohet nga KQZ u rrezuan të gjitha nivelin e vlerësimit administrativ nga KAS². Asnjë rast nuk iu referua Prokurorisë për vlerësim profesional kompetent apo për hetime të mëtejshme. KQZ dha KAS ushtruan kompetenca që me ligj i takojnë organit të hetimit (SPAK apo Prokurorive të juridiksionit të zakonshëm). Ushtrimi i kompetencave nga vetë KQZ për hetimin apo skualifikimin paraprak të denoncimeve, kallzimeve, sinjalizimeve për vepra të mundshme penale që çojnë zgjedhjet demokratike është një praktikë anti-ligjore dhe që implikon haptazi një mbivendosje të kompetencave institucionale. Veprimtaria e KQZ legjitimohet përmes Kodit Zgjedhor ndërkohë që veprat e

¹ Neni 328/b "Korrupsioni pasiv në zgjedhje", shtuar me ligjin nr. 89/2017, datë 22.5.2017

² <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/08/16/kqz-administroi-135-sinjalizime-denoncime-per-parregullsi-ne-zgjedhjet-e-25-prillit-asnje-nuk-u-referua-ne-prokurori/>

dyshuara penale që çënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve adresohen nga parashikimet ligjore që përmban Kodi Penal (Kreu X). Vlerësimi nga ana e institucionit të KQZ të denoncimeve të publikut është një praktikë e pa-motivuar ligjërisht e cila dublon rolin e institucioneve që janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve demokratike.

INFOCIP rekomandon abrogimin e ndryshimeve në Kodin Zgjedhor lidhur me adresimin/administrimin e denoncimeve të publikut, të bëra në vitin 2020 me konsensus. KQZ dhe KAS duhet të rikthehen në rolin e vet të natyrshëm të administrimit zgjedhor dhe të zhvishet nga kompetencat e vlerësimit paraprak të denoncimeve, të cilat potencialisht mund të jenë vepra penale që hetohen nga organi I prokurorisë.

Rekomandohet që KQZ (KAS specifikisht) të kenë vetëm kompetencën e përcjelles en-block të denoncimeve në Prokurori, nëse Portali i Denoncimeve nga Publiku do të vijojë të jetë nën administrimin direkt të KQZ. Vetëm Prokuroria mund të vendosë se në cilin nga rastet e denoncuar në këtë Portal mund të nisim (apo të mos nisim hetimet).

INFOCIP rekomandon që Prokuroria të ketë akses të barabartë në portalin që KQZ ka vënë në dispozicion të Publikut për denoncimin e veprave të mundshme penale që çënojnë sistemin demokratik të zgjedhjeve. Prokuroria nuk mund të kushtëzohet nga asnjë vendimarrje e KQZ apo KAS sa i takon vlerësimit të përmbajtjes së elementëve të veprës penale në denoncimet e depozituara në Portal.

INFOCIP rekomandon që Prokuroria të nisë një hetim për të vlerësuar nëse ka patur fshehje apo mos-referim të rasteve të denoncuar në KQZ, të cilat janë marrë në shqyrtim nga Dhoma përkatëse e institucionit, sa i takon zgjedhjeve të të 25 Prillit, 2021.

Nga vëzhgimi sistematik i praktikës së hetimit të krimeve të dyshuara zgjedhore, rezulton se organi i Prokurorisë konsumon në mënyrë të përsëritur afatet procedurale të hetimit pa arritur dot të dërgojë çëshjen në gjykatë. ***Rekomandohet që afatet e hetimit për krimin zgjedhor të jenë objekt vlerësimi tematik nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe nga ILD.***

Nga vlerësimi sistematik i deritanishëm, realizuar nga INFOCIP, organi i Prokurorisë nuk regjistron procedim penal për një numër të konsiderueshëm kallzimesh penale që depozitohen për krime të dyshuara zgjedhore. ***INFOCIP rekomandon që organi i akuzes nuk duhet të rezervojë të drejtën për të pushuar apo pezulluar hetimin ndaj veprave penale që ka nën hetim. Ky funksion/atribut duhet t'i përkasë ekskluzivisht gjykatës.***

Rekomandohet që pushimi i çështjeve penale që përmban në rastin konkret Kreu X i KP, të ndryshuar të bëhet me vendim gjykate.

Nisur nga rrethana e punësimeve në institucione publike apo agjensi shtetërore dhe kompani sh.a. para fushatës, rekomandohet zgjerimi në kohë i kompetencës lëndore të prokurorisë për të administruar kallzime penale nga subjektet politike/zgjedhore. Në zgjedhjet e fundit parlamentare, një pjesë e madhe e akuzave politike mes palëve kishin të bënin me përdorimin e funksionit publik për avantazh të padrejtë në zgjedhje si dhe me shitblerje vote të cilat ishin konsumuar përpara filimit zyrtar të fushatës zgjedhore.

Rekomandohet që vendimet e gjykatave që merren për vepra penale mbi parashikimet që përmban Kreu X i Kodit Penal duhet të bëhen publike në një nënkategori të posaçme online dhe të jenë të aksesueshme nga palët e interesuara që vlerësojnë ligjshmërinë e proceseve zgjedhore. Kjo kategori vendimet mund dhe duhet të jetë e disponueshme edhe nga KQZ, në formë diskrete apo dhe përmes një linku në faqen zyrtare.

Afati i hetimi për çështjet penale nga e prokurorisë si rregull zgjat 3 muaj. Ky konsiderohet edhe si afat procedural standard për kryerjen e një hetimi të plotë para se dosja të shkojë në gjykatë për vlerësim të mëtejshëm të fajësisë. Praktika e vëzhguar nga ky monitoring sugjeron se prokurorët kanë tejkaluar mesatarisht 4 herë këtë afat, duke marrë vendim për të shtyrje. *Rekomandohet që zgjatja e hetimit për rastet e parashikuara në Kreun X të KP, të ndryshuar, të bëhet vetëm një herë, me vendim gjykatë, ku prokuroria të ofrojë para saj prova për të bindur gjykatën mbi kërkesën për shtyrje.*

Dimensioni publik i procesit gjyqësor për shtyrje hetimi, apo edhe për vendime përfundimtare duhet të garantohet për median dhe palët e interesuara. Situata e Covid19 ka komprometuar të drejtën e publikut për të ndjekur senacat gjyqësore në sallë. Kjo e drjtë duhet të restaurohet dhe për çështjet e gjykimit që implikojnë vepra penale në fushën e zgjedhjeve, të lejohet dhe garantohet publiciteti i shtuar i seancës gjyqësore.

Rekomandohet që të perpilohen listat e prokuroreve të cilët kanë specializimin apo trajnim të mjaftueshëm për të hetuar krimin zgjedhor dhe të vlerësohen në tërësi nevojat e prokurorëve të tjerë për trajnime tematike të posaçme, konkretisht në fushën e hetimit të kallzimeve për vepra penale që çënojnë sistemin e zgjedhjeve demokratike.

Rezultatet e punës hetimore të prokurorëve të shortuar/të caktuar për të hetuar dhe çuar para drejtësisë personat apo subjektet që konsumojnë vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, parashikuar nga Kreu X i KP, të ndryshuar, rekomandohet të bëhen publike në një raport të posaçëm, të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, i cili i vihet në dispozicion KQZ jo më vonë se një vit nga data e përfundimit të zgjedhjeve më të fundit. Raporti Special për hetueshmërinë dhe ndëshkueshmërinë e krimit zgjedhor rekomandohet të përfshihet si një kapitull i posaçëm i analizës vjetore të organit të Prokurorisë që depozitohet më pas në Kuvend zyrtarisht.

Sistemi i regjistrimit të kallzimeve në prokurori duhet të rikonceptohet dhe të jetë i aksesueshëm online, për të ndjekur dinamikën e hetueshmërisë së krimit zgjedhor nga subjektet zgjedhore dhe nga çdo person apo organizatë e interesuar. Aktualisht të dhënat mbahen në regjistra të veçuar dhe përpunimi i tyre statistikor ndodh jashtë sistemeve të standartizuara.

Rekomandohet krijimi i një sistemi unik regjistrimi të çështjeve penale që çënojnë shtetin demokratik të zgjedhjeve në format të unifikuar online (pra jo në file excel-i, sikurse veprohet deri tani nga çdo prokurori rrethesh). Një sistem i posaçëm do të ndihmonte në vlerësimin e nivelit të incidencës, hetueshmërisë dhe performancës së punonjësve të prokurorisë në drejtim të hetimit që ajo i bëjnë në tërësi krimit dhe në mënyrë të posaçme krimit kundër sistemit demokratik të zgjedhjeve.

Së bashku me numrin e procedimeve penale, Prokuroritë e rretheve duhet të marrin masa për të informuar publikun përmes specifikimeve në sistemin e mbajtjes së të dhënave mbi numrin e personave të proceduar penalisht. Shpesh, për të njëjtin procedim penal ka më shumë se një person të kallzuar. ***Rekomandohet që numri i personave të hetuar/të kallzuar të jetë e dhënë publike në format statistikor, të përditësueshëm me bazë mujore.***

Rekomandohet që Policia e Shtetit të limitohet me ligj ose të vetë-limitohet sa i takon vendimarrjes nga ana e vetë asaj se cili prej denoncimeve duhet referuar në Prokurori dhe cili jo. Të gjitha denoncimet e administruara / depozituar prej saj, apo rastet e konstatuar nga vetë Policia e shtetit në flagrancë apo në rrugë operative, t'i referohen pa përjashtim Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor për veprime të mëtejshme procedurale në rastin e veprave të parashikuara në Kreun X të KP.

Rekomandohet që Policia e Shtetit të marrë trajnime të posaçme në këtë drejtim, për të parandaluar abuzimin nga ana e punonjësve të saj me funksionin e rëndësishëm që ajo luan në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, sidomos gjatë ditës së votimit, por edhe në kohë fushate si dhe gjatë numërimit të votave deri në shpalljen e rezultatit.

Pushime nga puna në kohë fushatë apo edhe marrja në punë e personave në kohë fushate duhet të administrohen nga DAP në një databazë të veçantë me akses publik. Rekomandohet krijimi i një Task Forcë në përbërje të së cilës të jenë përfaqësues të DAP, Inspektorati i Punës (ISHPSHSH), KQZ si dhe dy përfaqësues nga Shoqëria Civile që ka në fokus vlerësimin e veprave penale që lidhen me zgjedhjet apo pushimet nga puna në Administratën Publike.

I. Paraqitje e detajuar e gjetjeve

a) Kallëzime në SPAK- Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion

Në Dhjetor 2020, Kuvendi i dha SPAK-ut kompetenca ligjore për të hetuar rastet e korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, vepra këto të parashikuara nga nenet 328 dhe 328/b të Kodit Penal. SPAK i ushtroi kompetencet e reja për herë të parë në Zgjedhjet për Kuvendin, mbajtur në 25 Prill 2021. Qysh në periudhën e fushatës zgjedhore, në SPAK pati një numër të lartë kallëzimesh për shit/blerje të dyshuar të votës. Numri i kallëzimeve është i ndryshueshëm në çdo komunikim publik që SPAK ka iniciuar për këtë qëllim. Konkretisht:

Në datë **23 Prill 2021**, numri i kallëzimeve në SPAK për hetim të veprave penale në fushën e zgjedhjeve arriti në 91¹ dhe konkretisht:

- *Subjekte politike 55 raste, kallëzime (PD – 50; LSI – 3; PS – 1; FRD – 1)*
- *Institucioni i Presidentit të Republikës 18 raste, informacione.*
- *Policia gjyqësore 10 raste, referime.*
- *Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore 4 raste, procedime penale.*
- *Shtetas 4 raste, kallëzime.*

Dy ditë pas votimeve, pikërisht në datë 27 Prill 2021, SPAK përditësoi informacionin dhe njoftoi se kishte regjistruar dhe hapur hetim për 33 procedime penale, si më poshtë vijon:

- *27 procedime penale për “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 KP.*
- *2 procedime penale për “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Korrupsioni pasiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 328 dhe 328/b Kodi Penal.*
- *2 procedime penale për “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, parashikuar nga neni 328/a Kodi Penal. (E lidhur me subjekte në kompetencë të SPAK)*
- *1 procedim penal për “Shpërdorim detyre” dhe “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga nenet 248 dhe 328 KP.*
- *1 procedim penal për veprat penale “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” dhe “Përhapja e sekreteve vetjake”, parashikuar nga nenet 328 dhe 122 Kodi Penal.*

Në **Korrik 2021** kreu i SPAK, Z. Arben Kraja tha për Televizionin Publik Shqiptar se SPAK pati 149 raste apo njoftime për vepra penale të dyshuara në fushën e zgjedhjeve². Prej këtyre, SPAK regjistroi 59 procedime penale. Për 20 raste u vendos mosfillimi i procedimit penal pasi nuk pati patur të dhëna të mjaftueshme. Mes këtyre rasteve, ishin edhe 18 kërkesa për hetim të pëcjella nga

¹ Hap njoftimi zyrtar te SPAK në këtë link: <https://spak.al/2021/04/23/njoftim-23/>

² <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/08/13/spak-perditeson-te-dhenat-per-krimet-e-dyshuara-zgjedhore-nen-hetim/>

Presidenti i Republikës. Shifra e pohuar në intervistën televizive nga kreu i SPAK rezulton të jetë shumë më e lartë se ajo që SPAK ka njoftuar zyrtarisht në dy raste pararendëse.

Në 24 Dhjetor 2021 monitoruesit e INFOÇIP paraqitën kërkesë për informim pranë SPAK për të saktësuar mbi të dhënat statistikore mbi krimet e dyshuara zgjedhore. Nga informacioni i dhënë, rezultoi se viti 2021 u mbyll me **76 kallëzime** të regjistruara në SPAK. Për 22 procedime penale është marrë vendim për shpalljen e mos-kompetencës dhe është bërë kalimi i akteve tek Prokuroritë e Rretheve.

Janë dërguar në Gjykatë me kërkesë për gjykim 2 procedime penale me 4 të pandehur. Në njërin nga procedimet, Gjykata e Posaçme dha vendim me burg për dy të pandehurit³ (shih rasti i zyrtarëve të Bashkisë Dibër). Në rastin tjetër, SPAK ka mbyllur hetimet në datë 25 Nëntor 2021 dhe ka dërguar dosjen në ngarkim të një ish-kandidati për deputet në Gjykatën Speciale ku edhe do të gjykohet. Personat në fjalë janë akuzuar për shitblerje vote në Qarkun Zgjedhor Tiranë.

SPAK ka dërguar në Gjykatë me kërkesë për pushim 6 procedime penale. Aktualisht mbeten në hetim ende 27 procedime penale. Kjo do të thotë se SPAK nuk ka mundur do të konkludojë hetimet brenda afatit 6-mujor për gjysmën e kallëzimeve që ka regjistruar si procedime penale.

SPAK gjatë gjithë vitit 2021 funksionoi me 13 prokurorë, prej të cileve 5 prej tyre kanë patur fokus të posaçëm hetimin e procedimeve penale që do të regjistrohen në tematiken e krimit zgjedhor. Afati procedural në dispozicion të SPAK për realizimin/mbylljen e hetimeve për vepra penale te dyshuara është 6 muaj⁴, me të drejtë ripërsëritje. Ky afat është dyfish me i lartë se ai i prokurorive te zakonshme.

INFOCIP monitoroi rregullisht ecurinë e kallëzimeve penale në SPAK dhe arriti të dokumentojë 82 kallëzime, plus 13 transferime në SPAK nga prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm deri në datë 13 Dhjetor 2021. Nga të dhënat e rakorduara, rezulton se SPAK nuk regjistroi 18 kërkesa për hetim të përcjella nga Presidenti i Republikës si dhe një (1) referim nga policia gjyqësore. **Diferenca prej 76 kallëzimesh të regjistruara ku konkludon INFOCIP përkon me numrin e rasteve që SPAK ka konfirmuar zyrtarisht se ka në regjistrat e vet për vepra penale në fushën e zgjedhjeve.**

Të dhënat e rasteve të kallzuara në SPAK janë organizuar në një databazë të veçantë me akses publik⁵. Rreth 93% e totalit të kallëzimeve të paraqitura në SPAK janë të dokumentuara me faksimilet përkatëse, të cilat janë anonimizuar më parë. Për secilin nga kallëzimet e paraqitura është evidentuar subjekti që ka bërë kallëzimin, numri i personave ndaj të cilëve është bërë kallëzim, referenca ligjore që përlligj kallëzimin si dhe ecuria e çdo kallëzimi.

³ shih rasti i zyrtarëve të Bashkisë Dibër. Link: <https://www.krimizgjedhor.com/ep-admin/post.php?post=4431&action=edit>

⁴ neni 323, 324 I K.Pr.P. Version I përsitësuar, link: https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/09/kodi_i_procedures_penale_28_07_2017_1367_5285.pdf

⁵ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/databaza-e-kallzimeve-spak-2/>

tabele

Databaza pasqyron bashkinë si dhe qarkun zgjedhor në juridiksionin e të cilave bie vepra penale e dyshuar që është kallzuar në SPAK. Këto të dhëna ndihmojnë në krijimin e një panorame më të plotë të incidenteve zgjedhore të kallzuara apo të referuara në SPAK gjatë Zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Qarku zgjedhor me numrin më të lartë të kallzimeve në SPAK është Tirana me rreth 44 kallzime, pasuar nga Qarku Zgjedhor Fier me 9 dhe Qarku Zgjedhor Durrës me 8. Shifrat janë dokumentuar në kohë fushatë, por mund të jenë zvogëluar në një kohë më të vonë për shkak të procesit të transferimit të dosjeve.

Nga të dhënat e analizuara, rezulton se në SPAK është paraqitur kallzim/ankim në ngarkim të rreth 360 personave. Disa persona rezultojnë të jenë të kallzuar në më shumë se sa një denoncim. Kallzimi penal me numrin më të lartë të personave është paraqitur nga subjekti zgjedhor PD në datë 07/04/2021 (në Elbasan) dhe konkretisht ndaj 48 personave për të cilët pretendohen një numër akuzash, mes të cilave “grup i strukturuar kriminal” dhe “korrupsion aktiv në zgjedhje”⁶.

Edhe kallzimi i dytë më numrin më të madh të personave ndaj të cilëve pretendohet se kanë konsumuar krime zgjedhore është depozituar në SPAK po nga subjekti zgjedhor PD. Konkretisht bëhet fjalë për 44 shtetas të kallzuar penalisht në Qarkun Durrës⁷.

Presidenti i Republikës depozitoi 18 “kërkesa për hetim” në SPAK mbi incidente të raportuara tek vetë ai përmes një instrumenti fakt-mbledhës online. Ky instrument online denoncimesh u aktivizua nga Presidenti në fillim të fushatës elektorale. Pozita procedurale në këtë nuk është ajo e kallzuesit të drejtpërdrejtë por e sinjalizuesit që merr dijeni për elementë të veprës penale të dyshuar.

Presidentit të Republikësi bëri kërkesë të përsëritur SPAK për të hetuar mbi rrjedhjen e të dhënave personale të mbi 900 mijë qytetarëve për përdorim elektoral nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste. SPAK regjistroi procedi penal, por më pas shpalli mos-kompetencën, pasi vepra penale e dyshuar nuk binte në juridiksionin lëndor që SPAK ka në fushën e krimeve zgjedhore. Çështja në fjalë i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Tiranë.

Në ndryshim nga Presidenti i Republikës, subjekti zgjedhor Partia Demokratike ka marrë një pozitë të qartë procedurale lidhur me kallzimet që ka paraqitur në SPAK. Në shumicë prej tyre, kallzues është sekretari i përgjithshëm i kësaj partie, Z. Gazmend Bardhi.

b) Kallzime në Prokuroritë e Rretheve / Evidenca

Shqipëria ka 22 prokurori të juridiksionit të zakonshëm pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Në vijim të masave administrative dhe procedurale të ndërmarra nga Prokurori i Përgjithshëm për të

⁶

⁷ https://www.krimizgjedhor.com/?p=content/uploads/2021/05/k94_fq.1_anonimizuar.pdf

garantuar funksionimin normal të prokurorisë në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe ligjore për periudhën para, gjatë dhe pas zgjedhore, prokuroria është angazhuar për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, në kompetencë lëndore të juridiksionit të përgjithshëm.

Në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, mbajtur në 25 Prill 2021, Prokuroria e Përgjithshme ka treguar kujdes të shtuar në komunikimin me media dhe publikun për të dhënë informacion mbi situatën e kallëzimeve/njoftimeve për vepra të dyshuara penale që çenojnë zgjedhjet. Ajo shpërndau 6 herë njoftime për media me të dhënat e përditësuara për veprat penale në fushën e zgjedhjeve të depozituara pranë saj, respektivisht në datat 24 Prill, 27 Prill, 8 Maj, 20 Maj, 8 Qershor dhe 2 Nëntor 2021.

Sipas të dhënave më të fundit, të datës 2 Nëntor 2021, prokuroritë e juridiksionit të zakonshëm morën 158 njoftime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve prej të cilave, 91 drejtpërdrejt në formën e kallëzimeve në prokurori. Nga këto të fundit 70 njoftime përbëjnë kallëzime të subjekteve politike/kandidatëve drejtpërdrejt në prokurori, 3 njoftime të shtetasve në prokurori dhe 18 njoftime të institucioneve shtetërore në prokurori.

Deri në fund Nëntorit 2021, në prokuroritë e rretheve u raportuan si të regjistruar 82 procedime penale. Prej tyre 80 u regjistruan mbi bazën e kallëzimeve/referimeve, kurse 2 procedime u regjistruan kryesisht. Nga çështjet e regjistruara përfunduan me vendim pushimi 20 prej tyre. Janë pezulluar 3 çështje dhe janë në gjykim 4 çështje me 4 persona. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 34 njoftime. Nga prokuroritë e rretheve i janë transferuar për kompetencë lëndore SPAK-ut 24 njoftime.

Deri në datë 2 Nëntor 2021, është e konfirmuar zyrtarisht⁸ se ka patur 10 persona në ndjekje penale për krime të dyshuara në fushën e zgjedhjeve. Sipas të dhënave që ka bërë publikë Prokuroria e Përgjithshme, janë arrestuar në flagrancë 4 persona, është kërkuar masa e sigurisë “arrest në burg” për 3 persona dhe është pranuar kërkesa për 2 persona⁹.

Në fillim të Dhjetorit 2021, KQZ mori vendim për të depozituar kallëzime penale për prokuroritë e rretheve për 68 komisionerë. Në janar 2022, KQZ konformoi për INFOCIP se gjatë procesit të këqyrjes së fletëve të votimit rezultoi se anëtarët e grupeve të numërimit që kanë numëruar votat për këto qendra, kanë shënuar në tabelën e rezultatit të grupit të numërimit numër më të vogël votash një apo me shumë kandidatë të subjekteve zgjedhore dhe numër më të madh votash për një apo më shumë kandidatë të të njëjtit subjekt zgjedhor, krahasuar me numrin real të votave që u gjenden në kutinë e votimit. Rezultati i qendrës së votimit nuk pasqyron rezultatin real për të cilët zgjedhësit e këtyre qendrave janë shprehur nëpërmjet votimit. Kallëzimet penale janë dërguar në 7 prokurori, përkatësisht Prokuroria Korçë, Berat, Gjirokastër, Tirane, Lezhe, Elbasan dhe Shkodër. Në total janë kallëzuar 18 grupe numërimi, në total 67 persona

⁸ https://www.pp.gov.al/Media/Njoftime_per_Shtyp/Perditesim_mbi_veprat_penale_ne_fushen_e_zgjedhjeve.html

⁹ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/11/02/prokuroria-e-pergjithshme-ben-perditesimin-e-situates-per-krimet-zgjedhore/>

Po ashtu, nga procesi kryqëzimit të të dhënave të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI) në kuadër të këqyrjes paszgjedhore rezultoi se ka patur identifikim të dyfishtë (në një apo më shumë qendra votimi të të njëjtit identitet). Kjo rrethanë jep indicie të arsyeshme për ekzistencën e votimit të shumëfishtë për 32 raste. KQZ ka dërguar kallëzime në 11 prokurori, konkretisht Prokuroria Vlorë, Tirane, Shkodër, Lezhe, Korce, Gjirokaster, Fier, Elbasan, Durrës, Dibër, Berat.

Lidhur me kallëzimet e KQZ, prokuroria Berat ka konfirmuar regjistrimin e procedimit penal. Nuk ka dhëna të tjera për kohën që mbulon ku raport lidhur me regjistrimin e procedimeve të tjera penale nga prokuroritë e rrethve ndaj kallëzimeve të bëra nga KQZ. Praktika pararendëse sugjeron se kallëzimet e KQZ si rregull regjistrohet si procedime penale.

Bazuar në sa më sipër, mund të thuhet se deri në fund të vitit 2021, në adresë të prokurorive janë nisur rreth 176 ankime/kallëzime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Prej tyre fillimisht janë regjistruar 81 procedime penale. Kjo shifër pritët të rritet në rreth 99 procedime penale pas depozitimit prej KQZ të të paktën 18 kallëzimeve (për 67 komisionerë si edhe për 32 raste ku implikohet identifikimi biometrik i shumëfishtë)

SHËNIM METODOLOGJIK

Krahas vlerësimit të shifrave zyrtare që ka shpërndarë Prokuroria e Përgjithshme, për efekt të këtij monitorimi janë marrë të dhëna në rrugë operative ose përmes kërkesës për informim direkt nga prokuroritë e rretheve. Arsyeja kryesore e një qasje të tillë ka të bëjë me vlerësimin e incidencës së krimeve të dyshuara zgjedhore me bazë qarku dhe me pas edhe me bazë prokurorie. Shqipëria ka 12 qarqe zgjedhore dhe 22 prokurori rrethesh gjyqësore. Me përjashtim të Qarkut Elbasan dhe Berat, të gjitha qarqet e tjera kanë në përbërje të tyre nga dy rrethe gjyqësore, rrjedhimisht edhe nga dy prokurori të juridiksionit të zakonshëm.

Një tjetër arsye e mbledhjes së të dhënave “në burim” ka të bëjë me vlerësimin e koherencës së shifrave të referuara zyrtarisht nga Prokuroria e Përgjithshme. Sistemi i referimit të të dhënave statistikore që përdor organi i akuzës është rudimentar. Tabelat e mbajtjes së të dhënave janë me bazë excel-i dhe jo të integruara në një databazë me administrim qendror.

Për efekt të këtij monitorimit, INFOCIP krijoi një databazë online me akses publik e cila i organizon të dhënat e krimeve zgjedhore të kallzuara edhe me bazë qarku zgjedhor dhe me bazë prokurorie. Ndërkohë, të dhënat statistikore të ofruara nga Prokuroria e Përgjithshme janë përgjithësuëse dhe nuk diferencojnë me bazë prokurorie.; Ato nuk kënaqin kushtin metodologjik të monitorimit për të detajuar gjetjet mbi bazë qarku zgjedhor. Rrjedhimisht, mbledhja e të dhënave direkt nga prokuroritë e rretheve ishte e domosdoshme.

Mbledhja e të dhënave nga monitoruesit e INFOÇIP në 22 prokuroritë e rretheve nisi në fund të muajit Shtator dhe përfundoi në fillim të muajit Nëntor 2021. Nga të dhënat e disponuara, vihet re një mos-përputhje e lehtë me shifrat që ka bërë publike Prokuroria e Përgjithshme në datë 2 Nëntor 2021.

Situata faktike e paraqitur më poshtë nuk përfshin 18 kallëzime të depozituara nga KQZ në disa prokurori rrethesh. Këto kallëzime u depozituan në fund të muajit Dhjetor 2021, kohë në cilën ishte përfunduar marrja e të dhënave direkt nga prokuroritë e rretheve prej monitoruesve të INFOCIP.

Më poshtë paraqitet situata faktike e kallëzimeve të depozituara në 22 prokuroritë e rretheve:

1-Prokuroria Tiranë

Deri në fillim të Nëntorit 2021, në Prokurorinë e Tiranës rezultoi të depozituar gjithsej 33 kallëzime penale për krime të dyshuara zgjedhore. Nga ky total, 16 janë kallëzime të bëra direkt në Prokurori, 3 janë referime të policisë gjyqësore dhe 14 janë transferime nga SPAK.

Prej tyre¹⁰, 6 procedime penale kanë marrë vendim mosfillimi. Të paktën një (1) nga mosfillimet i takon çështjeve të ardhura me transferim nga SPAK (14 gjithsej). Deri në datë 1 Nëntor 2021, një (1) çështje rezultoi të jetë pushuar nga Prokuroria e Tiranës (ardhur me transferim nga SPAK). Kallëzimi për rastin konkret ka qenë i klasifikuar në fushën e veprimit të nenit 326 “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve”

Rreth 6 muaj nga mbarimi i periudhës zgjedhore, në Prokurorinë e Tiranës vijonte ende të ishte në verifikim paraprak 1 kallëzim për vepra penale të dyshuara në fushën e zgjedhjeve. Vetë Prokuroria Tiranë ka transferuar për kompetencë lëndore dhe/ose tokësore 3 kallëzime/procedime. Të paktën një nga këto çështje është dërguar SPAK, pasi bie ne parashikimet e nenit 238/b “Korrupsion Pasiv në zgjedhje”!

Pavarësisht nga numri i lartë i rasteve, të dhënat statistikore flasin për vetëm një person të arrestuar në flagrancë si dhe për vetëm një person nën hetim deri në nëntor 2021. Kjo e dhënë duhet marrë gjithsesi me rezervë, për shkak të sekretit hetimor. Prokuroria Tiranë ka bërë vetëm një kërkesë për arrest me burg të personit të dyshuar/nën hetim për vepra penale që çënojnë zgjedhjet e lira.

¹⁰ Shih tabela statistikore. Link: <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/11/Prokuroria-Tirane-INFOCIP-krime-zjedhore-Tabela-Permbledhese-07.10.2021.xlsx>

Nuk rezulton të ketë asnjë të akuzuar prej Prokurisë Tiranë që mund të këtë marrë dënim të formës së prerë nga një gjykatë shqiptare. Prokuroria Tiranë ka numrin më të madh të dosjeve nën hetim për krime të dyshuara zgjedhore të cilat i janë transferuar nga SPAK për kompetencë lëndore dhe tokësore. Janë plot 14 kallëzime penale të depozituara fillimisht në SPAK, të cilat janë transferuar në Prokurorinë Tiranë deri në datë 10 Nëntor 2021. Shumica prej këtyre dosjeve të transferuara tashmë, bien në parashikimet që pëmban neni 328/a “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”.

2- Prokuroria Kavajë

Në lidhje me procedimet penale për krimet të dyshuara zgjedhore, të regjistruara në Prokurorinë Kavajë, është ofruar informacion si më poshtë vijon:

- Për nenin 328 të Kodit Penal kallëzuar në Prokurori nga një subjekt politik një (1) çështje dhe është regjistruar procedim penal. Çështja penale ka qenë nën hetim deri në 15 tetor 2021.
- Për nenin 248 të Kodit Penal është bërë kallëzim në Prokurori nga një subjekt politik, një (1) çështje dhe është regjistruar procedimi penal.
- Për Nenin 248 të Kodit Penal kanë ardhur me transferim 3 çështje. Prej këtyre, një (1) çështje e kallzuar fillimisht SPAK është dërguar në Prokurorinë Fier dhe më pas nga Prokuroria Fier është dërguar me transferim në Prokurorinë Kavajë për kompetencë territoriale.
- Dy (2) çështjet e tjera që bien në parashikimet e nenit 248 të Kodit penal kanë ardhur direkt me transferim nga SPAK për kompetencë lëndore.

Për çështjet/kallëzimet e mësipërme, për njërën është vendosur mosfillimi i procedimit penal, kurse për të tjerat janë regjistruar procedime penale dhe janë aktualisht nën hetim. Prokuroria Kavajë ka sqaruar se më datë 27.09.2021 Gjykata e Rrethit ka shfuqizuar vendimin e mosfillimit të procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe është ri-regjistruar procedimi.

3- Prokuroria Fier

Deri ditën e zgjedhjeve, Prokuroria e Fierit konfirmoi për monitoruesie e INFOCIP se ajo administroi 17 kallëzime penale në fushën e zgjedhjeve. Në datë 4 Tetor 202, kjo prokurori saktësoi përmes komunikimit zyrtar se kanë përfunduar hetimet për 10 procedime penale të regjistruara prej saj. Dy nga procedimet e regjistruara janë bashkuar në një procedim të vetëm.

Në lidhje me këto procedime, nga ana e prokurorëve janë paraqitur në gjykatë kërkesat për pushimin e procedimeve. Nga këto ka përfunduar gjykimi për dy (2) procedime, duke pranuar

kërkesat e prokurorëve për pushimin e procedimit dhe janë ende në gjykim kërkesat për 6 procedime. Dy procedime janë ende në hetim nga organi hetimor.

Sipas subjektit zgjedhor Partia Demokratike, numri i kallëzimeve të paraqitura në këtë prokurori është më i madh. INFOCIP ka administruar si faksimile prej këtij subjekti 35 kallëzime në fushën e zgjedhjeve. Jo të gjitha prej tyre bien nëparashikimet që përmban Kreu X i Kodit Penal.

4- Prokuroria Lushnjë

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, deri më 30.09.2021, janë regjistruar gjithsej 19 kallëzime për vepra penale në fushën e zgjedhjeve. Prej tyre, 16 janë kallëzime të bëra direkt në Prokurori nga subjekti politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” kurse 3 janë referime nga Policia e Shtetit mbi bazën e kallëzimeve të subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Janë regjistruar 2 (dy) procedime penale për nenin 328/a i K.Penal, “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”, 1 (një) procedim për nenin 325 të K.Penal “Pengimi i subjekteve zgjedhore”.

Për 6 nga kallëzimet e regjistruara për nenin 328 K.Penal, janë regjistruar procedime penale për nenin 248 K.Penal (që nuk përfshihet në rrethin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve). Kallëzimet e tjera janë në proces verifikimi paraprak.

Pavarësisht se Prokuroria Lushnjë konfirmon gjithsej 19 kallëzime/njoftime për krime të dyshuara zgjedhore, subjekti zgjedhor PD dëshmon se vetëm ai ka formuluar 38 kallëzime në bashkitë mbi të cilat ka juridiksion Prokuroria Lushnjë. Në SPAK janë adresuar 5 prej këtyre kallëzimeve, kurse 33 të tjarat që mbeten në prokurorinë Lushnjë.

5- Prokuroria Elbasan

Sipas informacioneve të marra nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, rezulton se deri në datë 14 Tetor 2021 kanë qenë të regjistruara 5 kallëzime për krime të dyshuara zgjedhore. Prej këtyre, tre (3) kanë ardhur me transferim nga SPAK. Bie ne sy fakt se kallëzimet deri në datë 14 Tetor janë aktivizuar vetëm nga subjektet politike dhe/ose kandidatet që kanë garuar në Zgjedhjet e 25 Prillit.

Prokuroria e Elbasanit konfirmon gjithashtu se kallëzimet e depozituara direkt pranë saj (2 gjithsej) bien respektivisht në parashikimet e nenit 325 dhe 331/a të Kodit Penal, të ndryshuar. Ndërkohë, kallëzimet e përcjella nga SPAK për kompetencë kësaj prokurorie bien në parashikimet e neneve 328, 328/a dhe 331/a.

Prokuroria e Elbasanit ka marrë 1 vendim për pushim çështje (regj.per N.186/a), e cila korrespondon me çështjen e kallzuar mbi parashikimet që përmban neni 325 “Pëngimi i subjekteve zgjedhore”. Çështja në fjalë figuron e hapur si procedim mbi bazën e referimit të Policisë Gjyqësore, por edhe si kallëzime direkt në prokurori. Hetimet vijojnë ende për 4 procedime të tjera për vepra penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal.

6-Prokuroria Vlorë

Prokuroria e Vlorës ka administruar një total prej 8 njoftimesh/kallëzimesh për vepra penale të dyshuara si krime zgjedhore. Pas vlerësimit paraprak nga ana e kësaj prokurorie, janë regjistruar 5 procedime penale gjithsej për kallëzime në fushën e zgjedhjeve.

Sipas të dhënave që i janë vënë në dispozicion monitoruesve të INFOÇIP, Prokuroria e Vlorës ka vendosur mos-fillimin për 3 nga procedimet penale të regjistruara prej saj. Një nga 5 procedimet penale është pushuar. Në hetim, deri në datë 3 Nëntor 2021 kanë qenë ende 3 kallëzime.

Vetëm një (1) nga procedimet penale është hetuar plotësisht dhe materialet i kanë kaluar për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Vlorë.

7- Prokuroria Sarandë

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Sarandë janë regjistruar gjithsej 6 kallëzime penale/material hetimor për veprat penale që kanë lidhje me zgjedhjet. Për 2 kallëzime është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Një (1) prej tyre ishte regjistruar për veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, parashikuar nga neni 328 i K.Penal, ndërsa kallëzimi tjetër ishte regjistruar për veprën penale “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” të parashikuar nga neni 328/a i K.Penal.

Katër (4) kallëzimet që janë regjistruar si procedime penale renditen sipas specifikimeve të mëposhtme:

- *Një (1) procedim penal është regjistruar për veprat penale “Pëngim i subjekteve zgjedhore” dhe “Korrupsion aktiv në zgjedhje” parashikuar nga nenet 325 dhe 328 të K.Penal. Lidhur me këtë procedim penal fillimisht është shpallur mos-kompetenca dhe i është dërguar SPAK. Ky procedim është ri-kthyer nga SPAK dhe aktualisht vazhdojnë hetimet për veprën penale të parashikuar nga neni 325 i Kodit Penal në Prokurorinë Sarandë.*
- *Një (1) procedim penal është regjistruar për veprën penale “Korrupsion aktiv në zgjedhje” të parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, procedim penal për të cilin fillimisht është shpallur mos-kompetenca dhe i është dërguar SPAK. Ky procedim është kthyer nga SPAK*

dhe aktualisht po vazhdojnë hetimet për vepra të tjera penale që nuk kanë lidhje me zgjedhjet.

- *Një (1) procedim penal është regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve ” te parashikuara nga neni 326 i K.Penal. Për këtë procedim penal po vazhdojnë hetimet paraprake.*
- *Një (1) procedim penal është regjistruar për veprën penale “Demtim me dashje i materialit zgjedhor” të parashikuara nga neni 326/a i K.Penal. Aktualisht po vijohet me hetimet paraprake nga ana e Prokurorisë.*

8- Prokuroria Korçë

Prokuroria Korçë ka konfirmuar për monitoruesit e INFOÇIP se pranë saj ka patur 3 kallëzime për krime të dyshuara elektorale gjatë zgjedhjeve për Kuvendin në 25 Prill 2021. Nga të dhënat e disponuara në datë 13.10.2021 rezulton se:

- *Prokuroria e Korçës ka vendosur mosfillimin për kallëzimin/procedimin nr.423/2021, bazuar mbi parashikimet që përmban neni 328/a-1, e tij.*
- *Kallëzimi nr. 388/2021, i depozituar mbi parashikimet që përmban neni 328/a-1, është regjistruar si procedim penal me nr. 307/2021. Aktualisht, çështja është në hetim.*
- *Kallëzimi nr. 561/2021, nisur mbi parashikimet që përmban neni 331/a, është regjistruar si procedim penal me nr. 349/2021. Çështja penale në fjalë është dërguar në gjyq për pushim nga vetë prokuroria. Gjykimi nuk ka përfunduar ende.*

9- Prokuroria Pogradec

Prokuroria Pogradec konfirmon se ka administruar dy (2) kallëzime për krime të dyshuara zgjedhore. Sipas të dhënave të ofruara nga Prokuroria Pogradec, kallëzimet janë depozituar respektivisht nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste dhe Partia Demokratike. Për të dyja rastet është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Kallëzimet janë depozituar në kohë fushate. Për Partinë Demokratike kallëzimi është depozituar nga kandidati për deputet Edmond Spaho. Kallëzimi është referuar në nenin 329 të Kodit Penal “Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”.

10- Prokuroria Shkodër

Sipas informacioneve të nisura në rrugë zyrtare nga Prokuroria Shkodër, rezulton se deri në datë 6 Nëntor 2021, janë referuar gjithsej 8 kallëzime për krime të dyshuara zgjedhore; prej tyre Prokuroria Shkodër ka konfirmuar se ka regjistruar gjithsej 5 procedime penale.

Prokuroria e Shkodrës konfirmon se ka marrë vendim mos-fillimi për 3 kallëzime të depozituara pranë saj për vepra penale që bien në parashikimet e Kreut X të Kodit Penal, të ndryshuar.

Gjithashtu konfirmohet zyrtarisht se është pushuar 1 nga 5 procedimet e nisura, ndërkohë që është mbyllur hetimi dhe i është dërguar gjyqit 1 rast. Viojnë hetimet ende për 3 procedime të nisura për vepra penale të parashikuara nga Kreu X i Kodit Penal.

11- Prokuroria Durrës

Në Prokurorinë e Rrethit Durrës janë depozituar gjithsej 13 kallëzime penale për vepra penale në fushën e zgjedhjeve gjatë vitit 2021. Shtatë prej tyre janë kallëzime direkt në prokurori kurse 6 janë referime të policisë gjyqësore.

Sa i takon kallëzimeve direkte, një (1) prej tyre është depozituar nga subjekt politik kurse 6 janë depozituar nga institucione shtetërore. Pesë (5) prej këtyre kallëzimeve rezultojnë të jenë depozituar nga institucioni i Presidentit të Republikës.

Sa i takon referimeve të policisë gjyqësore (6 gjithsej), 3 janë denoncime nga kandidatë/subjekte, dy janë raste të konstatuara në vendngjarje dhe një denoncim është bërë nga shtetas i thjeshtë.

Nga të dhënat e disponuara zyrtarisht nga Prokuroria e Durrësit, nuk rezulton (deri në datën 7 Tetor 2021) që të jenë transferuar në adresë të saj nga SPAK çështje për kompetencë tokësore apo lëndore. Megjithatë nuk përjashtohet mundësia që kjo e dhënë të jetë e ndyshueshme.

Prokuroria e Durrësit ka marrë 7 vendime për mos-fillim të procedimit penal. Ky është një numër relativisht i lartë, po të mbahet parasysh totali i rasteve të kallzuara/referuara në këtë prokurori. Nga shqyrtimi i evidencave zyrtare që i janë vene në dispozicion INFOCIP, nuk rezulton gjithashtu të ketë persona të arrestuar në flagrance për krime të dyshuara zgjedhore.

Nuk konfirmohet asnjë hetim i përfunduar dhe kalim për gjykim i ndonjë procedimi penal në fushën e zgjedhjeve deri në dt 10 Nentor 2021.

Edhe pse 3 kallëzime janë depozituar nga subjektet zgjedhore për vepra penale të dyshuara që bien në parashikimet e nenit 328 “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, nga evidenca i cila i është vënë në

dispozicion INFOCIP nuk përcaktohet kalimi i tyre për kompetencë në SPAK. Në një rast të tillë, evidenca duhet marrë në konsideratë me rezervë.

12- Prokuroria Krujë

Prokuroria Krujë ka konfirmuar se ka nën hetim vetëm një procedim penal, regjistruar me nr. 182 më dt. 05.05.2021 për veprë penale parashikuar nga neni 329 i Kodit Penal. Procedimi në fjalë ka ardhur me transferim nga SPAK për mos-kompetencë lëndore dhe është kallzuar nga subjekti zgjedhor Partia Demokratike në ngarkim të shtetasve R.RR dhe Xh.R. Për këtë çështje vijojnë hetimet pranë kësaj prokurorie!

Në një dalje për mediat në datë 6 Maj 2021, subjekti zgjedhor Partia Demokratik shprehu pakënaqesi dhe pretendoi se SPAK nuk ka vepruar lidhur me kallëzime të përsëritura për blerjen e pretenduar të votave në Krujë, Thumanë dhe Fushë-Krujë.

13- Prokuroria Lezhë

Prokuroria Lezhë ka konfirmuar në tetor 2021 se ka patur vetëm një rast të dyshuar për krim zgjedhor nën hetim. Kallëzimi ka ardhur me transferim nga SPAK për kompetencë lëndore. Çështja në fjalë është regjistruar si procedim dhe është nën hetim (deri në dt. 20 tetor 2021). Dosja hetimore në fjalë është ndjekur nga prokuror Francesk Ganaj.

Gjatë fushatës zgjedhore, Policia referoi në Prokurori rastin e shtetasit me initiale G.P. i cili deklaroi në media, para kameras se kishte pranuar të merrte para në këmbim të votës. Shtetasi G.P. i shfaqur në video, sapo ishte kthyer nga puna në Malin e Zi, ku punon si punëtor sezonal. Rasti konkret implikon veprën e dyshuar penale të korrupsionit zgjedhor, për të cilin SPAK ka kompetencën lëndore.

14 - Prokuroria Gjirokastrë

Në Prokurorinë Gjirokastrë rezultojnë të jenë depozituar 16 kallëzime për vepra të dyshuara penale në fushën e zgjedhjeve¹¹. Prej tyre, 9 janë kallëzime në prokurori nga subjekte politike, një (1) është kallëzime nga një institucion shtetëror kurse një (1) kallëzim është depozituar nga një shtetas. Sipas regjistrit, janë katër (4) referime të Policisë Gjyqësore për vepra penale të dyshuara në fushën e zgjedhjeve. Po ashtu, një (1) kallëzim ka ardhur me transferim nga një prokurori tjetër e juridiksionit të zakonshëm.

¹¹ Shih për më tepër: <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/10/19/prokuroria-gjirokaster-krimet-zgjedhore-ende-pa-autor-fillojne-pushimet-e-dosjeve-penale/>

Rreth 8 kallëzime penale nga ato të përmenduar më sipër janë në referim të nenit 248 i Kodit Penal, “Shpërdorim i detyrës në lidhje me aktet ligjore për zgjedhësit”. Po ashtu nga evidencat¹² e kësaj prokurorie mësohet se 7 prej kallëzimeve që bien në parashikimet e nenit 248 të KP i janë përcjellë për kompetencë SPAK.

15- Prokuroria Përmet

Prokuroria Përmet ka patur gjithsej dy kallëzime gjatë periudhës zgjedhore. Konkretisht, pranë saj janë depozituar dy kallëzime nga Partia Demokratike, respektivisht për kryetarët e Bashkive Përmet e Këlcyre, bazuar në parashikimet që përmban neni 248 i K.P. për shpërdorimin e detyrës.

Të dyja këto kallëzime penale, sipas të dhënave të prokurorisë së këtij rrethi janë transferuar në SPAK. Veprat penale të referuara nuk bien në parashikimet Kreut X të K.P., por ato kanë sfond zgjedhor dhe janë dokumentuar në kuadër të këtij monitorimi.

16- Prokuroria Dibër

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, u regjistrua procedimi penal nr. 166/2021 me persona të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 328/a dhe 328 i Kodit Penal. Fashikulli hetimor është transferuar për kompetencë lëndore në SPAK më datë 24.04.2021. Gjithashtu, Prokuroria Dibër ka patur dhe një kallëzim penal, regjistruar me nr. 217/2021, që është dërguar gjithashtu për kompetencë në SPAK më datë 24.04.2021.

Në datë 24 Prill 2021, Gjykata e Dibres caktoi masën e sigurisë arrest me burg për shtesit D.Xh., me detyrë jurist i Bashkisë Bulqizë dhe A.C, 25 vjeç. Ndaj tyre rëndoi akuza për “korrupsion aktiv në zgjedhje”. Në datë 1 Qershor 2021, Gjykata e Posaçme e Apelit Ia në fuqi masën e arrestit me burg Denis Xholin dhe Albjon Çekun, të arrestuar më herët në dyshimin e korrupsionit në zgjedhje.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dënoi me nga 1 vit burg dy shtetasit D.Xh dhe A.C., të cilët u gjetën fajtor për akuzat e korrupsionit në zgjedhjet. Ata u dënuan me 18 Muaj burg, por duke zbritur kohën e paraburgimit, masa e vuajtjes së dënimit për secilin nga autorët e shpallur fajtorë u caktua 12 muaj burgim. Ky përbën edhe rastin e vetëm të aplikimit të një dënimi penal me vendim gjykate ndaj personave ndaj të cilëve u ngritën akuza për krime zgjedhore në Zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

17- Prokuroria Berat

¹² <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/11/TABELA-PROKURORIA-GJIROKASTER-KRIME-ZGJEDHORE-NE-HETIM.xlsx>

Sipas informacioneve të nisura në rrugë zyrtare nga Prokuroria Berat, rezulton se deri në fillim të Nëntorit 2021, kanë qenë të depozituara tre kallëzime për krime të dyshuara zgjedhore. Sa i takon ecurisë së hetimeve mbi këto tre çështje, Prokuroria e Beratit konformoi për INFOCIP sa më poshtë:

1. *Për njërën nga çështjet është bërë kërkesë në gjykatë për pushim nga vetë Prokuroria Berat. Kallëzues në çështjen në fjalë është subjekti zgjedhor Partia Demokratike.*
2. *Prokuroria e Beratit ka vendosur mos-fillimin për kallëzim/çështje penale e cila ka ardhur për kompetencë nga SPAK. Çështja në fjalë referon nenin 328/a të Kodit Penal dhe për të është vendos mosfillim nga Prokuroria e Beratit.*
3. *Në lidhje me një referim të bërë nga policia për një të mitur që ka gjuajtur me gurë një qendër zgjedhore është vendosur pushimi i çështjes.*

18- Prokuroria Kukës

Prokuroria Kukës nuk ka të regjistruar asnjë kallëzim apo procedim penal të nisur për veprat penale në fushën e zgjedhjeve. Konfirmimi është dhënë nga kreu i Prokurorisë së rrethit Kukës, Xhevahir Lita për monitoruesit e INFOCIP.

19. Prokuroria Kurbin

Nuk ka asnjë rast të dokumentuar zyrtarisht në të dhënat e përditësuara nga Prokuroria Kurbin deri në nëntor 2021. Gjatë procesit të monitorimit të fushatës zgjedhore, u dokumentuar megjithatë një referim nga ana e Policisë Gjyqësore që bie në parashikimet e nenit 326 të Kodit Penal.

20-Prokuroria Pukë

Policia ka referuar në Prokurorinë e Pukës materialet hetimore në ngarkim të shtetasit V.Sh. (i arrestuar) dhe shtetasit D.S. (i proceduar në gjendje të lirë). Personat janë arrestuar në flagrancë dhe janë akuzuar për veprat penale “Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe i rezultateve të zgjedhjeve” dhe “Korrupsioni aktiv në zgjedhje, kryer në bashkëpunim” (nenet 326/328)¹³.

INFOCIP ka dokumentuar gjithashtu edhe një rast tjetër si referim të policisë Gjyqësore që bie në parashikimet e nenit 88. Ngjarje që ka ndodhur në një qendër votimi me një person të arrestuar në

¹³ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/04/10/puke-hartonin-lista-me-te-dhenat-e-kartave-te-identitetit-duke-premtuar-leke-ne-kembim-te-votes-vihet-ne-pranga-sekseri/>

zonën e Fushë-Arrësit¹⁴. megjithatë, ky rast nuk reflektohet në tabelën përmbledhëse në fund të të këti kapitulli pasi vepra penale e plagosjes së personit nuk klasifikohet si krim zgjedhor.

21-Prokuroria Tropojë

Prokuroria Tropojë vendos mosfillimin e procedimit penal për dy kallëzime për krime të dyshuara zgjedhore. Të dyja ngjarjet janë depozituar si kallëzime në periudhën e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e 25 Prillit për Kuvendin e Shqipërisë.

Ngjarja e parë është një referim rasti nga ana e Policisë së Tropojës, në ngarkim të shtetasit me iniciale I.M, për një ngjarje të ndodhur në fshatin Ragam, Njesia Administrative Llugaj Tropojë. Ngjarja ka ndodhur në datë 15.04.2021, teksa në këtë fshat zhvillohej një tubim elektorale i subjektit zgjedhor Partia Socialiste.

Ngjarja e dytë, për të cilën është referuar kallëzim në prokurori nga Policia e Tropojës ka të bëjë sërish me një takim elektorale të Partisë Socialiste. Në datë 09.04.2021, teksa PS ka qenë duke zhvilluar një takim të planifikuar elektorale, është konstatuar një mjet fluturues, dron, i cili i cili mbante një flamur të subjektit politik Partia Demokratike.

22-Prokuroria Mat

Prokuroria Mat nuk ka të regjistruar asnjë kallëzim apo procedim penal të nisur për veprat penale në fushën e zgjedhjeve.

Tabela e përplotësuar:

Kallëzime të inicuar nga KQZ

Në datë 3 dhjetor 2021¹⁵, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në seancë publike shqyrtoi dhe miratoi vendimin “*Për miratimin e raportit mbi gjetjet kyçe të procesit të kryqëzimit të të dhënave elektronike dhe biometrike të mbledhura nga pajisjet e identifikimit elektronik në zgjedhjet për Kuvend të datës 25.04.2021*”.

Nga procesi kryqëzimit të të dhënave të pajisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve (PEI) janë verifikuar disa raste të identifikimit të dyfishtë (në një apo më shumë qendra votimi të të njëjtit identitet). Kjo e dhënë përbën indicia të arsyeshme për ekzistencën e votimit të shumëfishtë për 32

¹⁴ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/04/25/puke-plagoset-polici-ne-qender-te-votimit-autori-nuk-ishte-votues-i-asaj-qendre/>

¹⁵ <http://kqz.gov.al/2021/12/03/miratohen-raportet-e-verifikimit-paszgjedhor-te-10-te-qendrave-te-votimit-te-zgjedhjeve-te-dates-25-prilli-2021/>

raste. KSHZ vendosi miratimin e raportit dhe të bëhet kallëzim pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga 20 shtetas në 35 qendra votimi. KQZ ka dërguar kallëzim penal për rastet e dyshuara në 11 prokurori, konkretisht Prokuroria Vlorë, Tiranë, Shkodër, Lezhe, Korçë, Gjirokaster, Fier, Elbasan, Durrës, Dibër, Berat. Konfirmimi lidhur me incimin e kallëzimeve penale është dhënë në rrugë zyrtare për monitoruesit e INFOÇIP.

Në të njëjtën mbledhje u shqyrtua nga KSHZ si dhe u miratua vendimi “Për miratimin e raporteve mbi gjetjet kyçe të procesit të këqyrjes paszgjedhore të fletëve të votimit, materialit zgjedhor dhe pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik (PEVN) të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

KSHZ vendosi të bëjë kallëzim penal pranë organit të prokurorisë për shkeljet e konstatuara nga 67 anëtarët e 18 grupeve të numërimit¹⁶.

Gjatë procesit të këqyrjes së fletëve të votimit rezultoi më disa raste se anëtarët e grupeve të numërimit kanë paraqitur të dhëna që nuk përputhen. Ata kanë shënuar në tabelën e rezultatit të grupit të numërimit numër më të vogël votash për një apo me shume kandidatë të subjekteve zgjedhore dhe numër më të madh votash për një apo më shumë kandidatë të të njëjtit □subject zgjedhor, krahasuar me numrin real të votave që u gjenden në kutinë e votimit. Në këtë mënyrë rezultati i qendrës së votimit nuk pasqyron rezultatin real të cilët zgjedhësit e këtyre qendrave kanë shprehur nëpërmjet votimit. Kjo e dhënë krijon dyshim të arsyeshëm për favorizim prej komisionerëve të një apo më shumë kandidatë të listave shumemërore të subjekteve zgjedhore. Ky është konkluzioni në të cilin ka mbërritur KQZ gjatë

Sipas konfirmimit zyrtar të ofruar për INFOÇIP nga KQZ, kallëzimet penale janë dërguar në 7 prokurori, përkatësisht Prokuroria Korçë, Berat, Gjirokastër, Tirane, Lezhë, Elbasan dhe Shkodër. Ne total janë kallëzuar 18 grupe numërimi, gjithsej 67 persona.

Deri në fund të Dhjetorit 2021, KQZ konfirmoi se prokuroria e rrethit Berat ka regjistruar procedimin penal për kallëzimet e paraqitura. Nuk ka të dhëna sa i takon prokurorive të tjera, por pritet që edhe ato të vijojnë me regjistrimin e procedimit penal për komisionerët.

Kallëzimet e KQZ i shtohen në këtë mënyrë numrit të kallëzimeve që janë depozituar në prokuroritë e juridiskionit të zakonshëm. Nëse për bazë referimi do të merret shifra zyrtare prej 158 kallëzimesh gjithsej që Prokuroria e Përgjithshme publikoi në datë 2 Nëntor 2021, atëherë mund të thuhet se deri në fund të vitit 2021, duke shtuar edhe 18 kallëzimet e KQZ, **shifra mund të ketë shkuar në 176 (109 direkt në formën e kallëzimeve, kurse pjesa tjetër në formë referimesh). Numri i procedimeve penale të regjistruar pritet gjithashtu të rritet nga 92 që ka qenë deri në fund të nëntorit në rreth 100 deri në fund të vlerësimit paraprak nga Prokuroria të kallëzimeve që ka depozituar KQZ.**

¹⁶ hap linkun për të parë tabelën zyrtare me komisionerët e kallëzuar penalisht: http://kqz.gov.al/ep-content/uploads/2021/12/lidhja_grupet_e_numerimit.pdf

Vlen të theksohet në këtë kapitull për KQZ se kallëzimet e paraqitura prej saj janë rezultat i verifikimit pas zgjedhor për vetëm 10% të qendrave të votimit të zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021. Në rast të verifikimit hipotetik të 100% të qendrave të votimit numri i parregullsive të konstatuara mund të ishte më i madh. Rrjedhimisht, në përmbushje të detyrimit të saj ligjor, KQZ mund të ishte e detyruar të depozitonte kallëzim penal për një numër shumë herë më të lartë komisionerësh.

c) Sinjalizime në KQZ

Në 26 dhjetor 2020 u ngrit pranë KQZ ndërfaqja/ platforma e aktiviteteve të ndaluara <https://aktivitete.kqz.gov.al> e cila u ofroi mundësinë partive politike, OJF-ve dhe qytetarëve për të denoncuar shkeljet e kufizimeve të parashikuara në Vendimin nr.9/2020 për përdorimin e burimeve shtetërore në periudhën zgjedhore.

Më 9 Mars, Komisioni Rregullator pranë KQZ miratoi gjithashtu projektvendimin “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit të denoncimeve”, si pjesë e mekanizmave të rinj të Kodit Zgjedhor që synuan të rrisin rolin e KQZ si një organ që heton proaktivisht denoncimet ndaj subjekteve zgjedhore, partive politike dhe organeve të administrates publike për përdorimin e burimeve shtetërore dhe më gjerë. Portali <http://kqz.gov.al/kallzo> nisi funksionimin në të njëjtën ditë në faqen e internetit të KQZ-së.

Përfshirja e publikut në denoncimin e parregullsive zgjedhore nëpërmjet këtyre dy platformave u zyrtarizua nëpërmjet ndryshimeve të aprovuara nga Kuvendi i Shqipërisë më 17 dhjetor 2020, në ligjin nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”¹⁷.

Në datë 12 Gush 2021, INFOÇIP iu drejtua me një komunikim zyrtar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KQZ për të vlerësuar sa ka qenë numri i përgjithshëm i denoncimeve të depozituara nga subjektet zgjedhore dhe nga qytetarët në Portalin e Denoncimeve të ndërlidhur me faqën zyrtare të KQZ.

Sipas përgjigjes zyrtare të kthyer nga KQZ në datë 17 Gusht 2021, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u regjistruan 135 sinjalizime/denoncime për Zgjedhjet e 25 Prillit 2021¹⁸. **Këto denoncime janë kryer si më poshtë vijon:**

- 36 denoncime nga subjekti zgjedhor LSI
- 32 denoncime nga subjekti zgjedhor nga PD
- 28 denoncime të dorëzuar nga portali i Institucionit të Presidentit të Republikës
- 21 denoncime nga OJF-të

¹⁷ Ndryshuar me ligj Nr. 150/2020 date 17.12.2020: <https://www.krimizgjedhor.com/ep-content/uploads/2021/09/per-sinjalizuesit-ndryshime-20201228120547ligj-nr.-150-dt.-17.12.2020-6-1.pdf>

¹⁸ <https://www.krimizgjedhor.com/index.php/2021/08/16/kqz-administroi-135-denoncime-per-parregullsi-ne-zgjedhjet-e-25-prillit-asnje-referim-ne-prokurori/>

- 18 denoncime nga qytetarë dhe sinjalizues anonimë
- 1 denoncim nga institucion publik

Nga të dhënat zyrtare të KQZ, rezulton se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar dhe është shprehur me vendim **këto denoncime** duke caktuar:

- 4 *masa administrative;*
- 16 *njoftime për marrje masash;*
- 59 *hetime administrative të përfunduara pa konstatim shkelje;*
- 28 *çështje vendim për mosfillim procedure*
- 14 *shpallje moskompetencë;*
- 13 *trajtuar me shkresë zyrtare*

KQZ nuk ka konsideruar të nevojshme që të investojë prokurorinë ose SPAK në ndonjë prej denoncimeve të shqyrtuara administrativisht, duke mos konstatuar element të veprës penale. Kodi Zgjedhor dhe ndryshimet në ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” synuan përfshirjen e KQZ si një organ referues në fushën e krimeve zgjedhore. Kompetencat e reja të ngarkuara nga ligji, parashikuan ngritjen e një “njësie përgjegjëse për marrjen dhe trajtimin e sinjalizimeve”. Pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, dhe në rast se konstatohen element të veprës penale, njësia hetimore pranë KQZ është e detyruar “të njoftojë menjëherë prokurorinë”.